



FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

www.qbz.gov.al

Nr. 32

13 mars

2013

P Ë R M B A J T J A

	Faqe
Dekret nr. 7964 datë 27.2.2013	Për dhënie të shtetësisë shqiptare..... 1311
Dekret nr. 7966 datë 28.2.2013	Për lejimin e lënies së shtetësisë shqiptare..... 1311
Vendim i KM nr. 141, datë 20.2.2013	Për autorizimin e Ministrisë së Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës për lidhjen e shtesës së kontratës me studion e avokatisë, të përzgjedhur për përfaqësimin në çështjen e arbitrazhit ndërkombëtar kundër shoqërisë “CEZ”, a.s..... 1312
Vendim i KM nr. 151, datë 27.2.2013	Për një ndryshim në vendimin nr.378, datë 12.8.1999 të Këshillit të Ministrave “Për kalimin e së drejtës së përfaqësuesit të pronarit për disa objekte, pronë publike, organeve të qeverisjes vendore”, të ndryshuar..... 1313
Vendim i KM nr. 155, datë 27.2.2013	Për përcaktimin e autoritetit kontraktues për dhënien me koncesion të hidrocentralit “Malla” dhe miratimin e bonusit, në procedurën përzgjedhëse konkurruese, që i jepet shoqërisë..... 1314
Udhëzim i MF nr. 9/1, datë 25.2.2013	Për përgatitjen e buxhetit vendor..... 1314
Udhëzim MPPT nr. 1, datë 26.2.2013	Për kompensimin dhe asistencën e pasagjerëve në rastin e mospranimit në bord të avionit dhe anulimit ose vonesës gjatë fluturimeve..... 1322
Udhëzim i MF, MPPT nr.581/1, datë 6.2.2013	Për përcaktimin e tarifave të shërbimit në Autoritetin Portual Durrës..... 1329

DEKRET
Nr. 7964, datë 27.2.2013

PËR DHËNIE TË SHTETËSISË SHQIPTARE

Në mbështetje të nenit 92, pika “c” dhe 93 të Kushtetutës, si dhe të neneve t9, 10 dhe 20 të ligjit nr. 8389, datë 5.8.1998 “Për shtetësinë shqiptare”, të ndryshuar, bazuar edhe në propozimin e Ministrisë të Brendshme,

DEKRETOJ:

Neni 1

U jepet shtetësia shqiptare me kërkesë të tyre personave të mëposhtëm:

1. Seyfettin Hakki Çalişkan
2. Halil Mehmet Sarişođlu
3. Lucia Ion Zeza (Diacenco)
4. Anna Marie George William Sturm
5. Antonio Mario Urbinati
6. Musa Isuf Hoxha
7. Vera Gomali Ramaj (Dimitriu)
8. Kenan Hikmet Çakmak
9. Ilir Zekë Ukaj
10. Suat Nazim Serbest
11. Yagmur Suat Serbest
12. Ecem Suat Serbest

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë.

PRESIDENTI I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
Bujar Nishani

DEKRET
Nr. 7966, datë 28.2.2013

PËR LEJIMIN E LËNIES SË SHTETËSISË SHQIPTARE

Në mbështetje të nenit 92 pika “c” dhe nenit 93 të Kushtetutës, si dhe të neneve 15 dhe 20 të ligjit nr. 8389, datë 5.8.1998 “Për shtetësinë shqiptare”, të ndryshuar, bazuar edhe në propozimin e Ministrisë të Brendshme,

DEKRETOJ:

Neni 1

U lejohet lënia e shtetësisë shqiptare me kërkesë të tyre personave të mëposhtëm:

1. Ermelinda Ndoc Kitowski (Shllaku)
2. Gentjan Shyqyri Kryeziu
3. Valdete Rifat Wendschuh (Ymeri)
4. Eglantina Kujtim Xhamaqi (Durre)
5. Artenida Hasan Schneider (Shingjini)
6. Gentjan Zenel Shima



7. Anila Jak Hildebrand (Jaku)
8. Alketa Tahir Abazaj
9. Claudia Kujtim Murati
10. Georgios Ketjou Abazaj
11. Bardhe Ismail Froß (Vokshi)
12. Gabriel Tanush Pietzka
13. Samanta Kujtim Aga
14. Entela Ferit Jonuzi
15. Astrit Idajet Saliaj
16. Evisi Muhamet Bala
17. Etleva Riza Schermin (Hasa)
18. Marsida Sokrat Daka
19. Erton Ferid Kurti
20. Elisa Sokrat Daka
21. Klaudeta Emri Lala (Çakrri)
22. Xhuljeta Faik Gjinia (Halili)
23. Mimoza Hasan Avdija (Godina)
24. Bashkim Avdi Avdija
25. Sibeta Burhan Çanga
26. Monika Jani Knoll (Çomo)
27. Ganimete Xhevit Distelhut (Molla)
28. Servjola Fatos Beqiraj
29. Oreada Hetem Bidaj
30. Maria (Adelina) Sotir Kola
31. Saimir Nazif Luca
32. Alban Lame Luzi
33. Adela Skender Pitani
34. Korozana Ilir Çelaj
35. Lulzim Hazis Fejzulla

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë.

PRESIDENTI I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
Bujar Nishani

VENDIM

Nr. 141, datë 20.2.2013

**PËR AUTORIZIMIN E MINISTRISË SË EKONOMISË, TREGTISË DHE ENERGJETIKËS
PËR LIDHJEN E SHITESËS SË KONTRATËS ME STUDIOIN E AVOKATISË, TË
PËRZGJEDHUR PËR PËRFQËSIMIN NË ÇËSHTJEN E ARBITRAZHIT
NDËRKOMBËTAR KUNDËR SHOQËRISË “CEZ”, A.S**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 4 pika 7, 5 pika 1 shkronja “b”, 12, pikat 2 e 6, 15 pika 8, dhe 18 pika 2 të ligjit nr. 10 018, datë 13.11.2008 “Për Avokaturën e Shtetit”, me propozimin e Zëvendëskryeministrit dhe Ministër i Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Autorizimin e Ministrisë së Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës (METE) për lidhjen e shtesës së kontratës me studion ligjore ndërkombëtare “Derains&Gharavi”, e cila është përzgjedhur përmes një procedure konkurruese për të ofruar këshillim ligjor për këtë ministri.

2. Objekt i shtesës së kontratës të jetë përfaqësimi i Republikës së Shqipërisë/METE, nga ana e studios ligjore, në arbitrazhin ndërkombëtar kundër shoqërisë “CEZ”, a.s., në cilësinë e paditësit ose të paditurit kundërpaditës.

3. Shpenzimet për pagimin e studios së huaj të avokatisë, në vlerën 900 000 (nëntëqind mijë) euro, të përballohen nga fondi rezervë i buxhetit të shtetit, për vitin 2013.

4. Ngarkohen Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Ministria e Drejtësisë dhe Avokatura e Shtetit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM

Nr. 151, datë 27.2.2013

**PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR.378, DATË 12.8.1999 TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE “PËR KALIMIN E SË DREJTËS SË PËRFAQËSUESIT TË PRONARIT PËR
DISA OBJEKTE, PRONË PUBLIKE, ORGANEVE TË QEVERISJES VENDORE”, TË
NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 4 të ligjit nr.7926, datë 20.4.1995 “Për transformimin e ndërmarrjeve shtetërore në shoqëri tregtare”, të ndryshuar, të neneve 13, 14 e 15 të ligjit nr.8743, datë 22.2.2001 “Për pasuritë e paluajtshme shtetërore”, të ndryshuar, të nenit 8/a të ligjit nr.8744, datë 22.2.2001 “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore”, të ndryshuar, dhe të nenit 3 të aktit normativ nr.4, datë 9.7.2008 “Për privatizimin dhe dhënien në përdorim shoqërive tregtare dhe institucioneve shtetërore të ndërmarrjeve apo objekteve të veçanta, mjeteve kryesore dhe mjeteve të xhiros së këtyre ndërmarrjeve”, miratuar me ligjin nr.9967, datë 24.7.2008, me propozimin e zëvendëskryeministrit dhe Ministër i Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në listën e objekteve, që i bashkëlidhet vendimit nr.378, datë 12.8.1999 të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, të hiqet prona me emërtimin: “- Nd. Metalike “Tirana””, Tiranë, pjesa e mbetur pa privatizuar.

2. Prona “Nd. Metalike “Tirana””, përmendur në pikën 1 të këtij vendimi, transferohet në përgjegjësi administrimi të Ministrisë së Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës.

3. Ngarkohen Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Ministria e Brendshme dhe Bashkia Tiranë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha



VENDIM
Nr. 155, datë 27.2.2013

**PËR PËRCAKTIMIN E AUTORITETIT KONTRAKTUES PËR DHËNIEN ME
KONCESION TË HIDROCENTRALIT “MALLA” DHE MIRATIMIN E BONUSIT, NË
PROCEDURËN PËRZGJEDHËSE KONKURRUESE, QË I JEPET SHOQËRISË**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5 pika 3 e 23 pika 3 shkronja “b” të ligjit nr.9663, datë 18.12.2006 “Për koncesionet”, të ndryshuar, me propozimin e Zëvendëskryeministrit dhe Ministër i Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Autoriteti kontraktues për kryerjen e procedurave ligjore për dhënie me koncesion, të formës “BOT” (ndërtim, operim dhe transferim), të hidrocentralit “Malla” është Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës.

2. Miratimin e bonusit prej 2 (dy) pikësh për rezultatin teknik dhe financiar në procedurën përzgjedhëse konkurruese për dhënie me koncesion të këtij hidrocentrali, që i jepet shoqërisë “Marsian Service”, sh.p.k.

3. Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, në procedurën përzgjedhëse konkurruese për dhënie me koncesion të hidrocentralit “Malla”, duhet të pranojë oferta për të gjithë pjesën e lirë të pellgut ujëmbledhës, i cili përfshihet në skemën e shfrytëzimit të këtij hidrocentrali.

4. Ngarkohet Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

UDHËZIM
Nr.9/1, datë 25.2.2013

PËR PËRGATITJEN E BUXHETIT VENDOR

Në përputhje me ligjin nr. 9936, datë 26.6.2008, neni 24 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, Ministri i Financave

UDHËZON:

1. Hyrje

Ky udhëzim përmban:

- Tavanet përgatitore të shpenzimeve të programit buxhetor afatmesëm 2014-2016;
- Transferten e pakushtëzuar për njësitë e qeverisjes vendore;
- Procedurat dhe afatet për përgatitjen e buxhetit afatmesëm 2014-2016;
- Mënyrën e llogaritjes së transfertave të pakushtëzuara dhe të kushtëzuara për njësitë e qeverisjes vendore.

2. Tavanet përgatitore të PBA-së

- Tavanet përgatitore të PBA-së për çdo program miratohen nga Këshilli i Njësisë së Qeverisjes Vendore brenda muajit mars 2013.

- Kuadri ekonomik 2014-2016, përcakton kontekstin ekonomik për Programin Buxhetor Afatmesëm 2014-2016. Ai pasqyron parashikime të treguesve ekonomikë dhe financiarë të buxhetit të njësisë së qeverisjes vendore për tri vitet e ardhshme, duke ofruar vlerësime të burimeve që njësia vendore do të ketë në dispozicion për të financuar shpenzimet e saj.

- Këto vlerësime sigurojnë bazën për njësitë e qeverisjes vendore për të përcaktuar tavanet e shpenzimeve të PBA-së.

3. Transferta e pakushtëzuar e njësive të qeverisjes vendore

- Niveli i transfertës së pakushtëzuar për vitet 2014-2016 (së bashku me të ardhurat nga taksat dhe tarifat vendore), financon funksionet dhe kompetencat që janë transferuar në pushtetin vendor deri në vitin 2013. Për transferimin e funksioneve që mund të bëhen në të ardhmen, niveli i transfertës së pakushtëzuar do të shtohet në varësi të funksioneve ose kompetencës së transferuar dhe faturës përkatëse të saj.

- Transferta e pakushtëzuar për vitin 2014, do të jetë afërsisht 3 % më e madhe se transferata e pakushtëzuar nga buxheti i shtetit e vitit 2013, ajo e vitit 2015, 3% më e lartë se ajo e vitit 2014, dhe transferata e vitit 2016 do të jetë 3% më e lartë se ajo e vitit 2015.

- Transferta e pakushtëzuar për periudhën 2014-2016:

Në mijë lekë

Bashki/komunë/qark	2014	2015	2016
Bashki/komunë	10,990	11,388	11,707
Qark	1,088	1,127	1,158
Totali	12,078	12,515	12,865

4. Procedurat dhe afatet për përgatitjen e PBA-së

- Kalendarit të përgatitjes së PBA-së miratohet nga Kryetari i Grupit për Menaxhim Strategjik (GMS) të Njesisë së Qeverisjes Vendore.

- DEMP-t, paraqesin kërkesat buxhetore dhe kërkesat shtesë sipas programit të nëpunësi autorizues i NjQV-së, brenda datës 15 maj 2013.

- Kërkesat buxhetore të dorëzuara të nëpunësi autorizues i njësisë së qeverisjes vendore vlerësohen dhe miratohen nga GMS-ja e NjQV-së.

- Nëpunësi autorizues i njësisë së qeverisjes vendore paraqet pranë këshillit të njësisë së qeverisjes vendore dokumentin e PBA-së 2014-2016, të miratuar nga GMS-ja, brenda datës 15 qershor 2013.

- Afati i dorëzimit të kërkesave buxhetore bashkë me kërkesat shtesë nga drejtuesi i ekipit të menaxhimit të çdo programi të nëpunësi autorizues i njësisë së qeverisjes vendore është 15 maj 2013.

- Kurset e këmbimit për vitet 2008-2013, dhe parashikimi për vitet 2014-2016, jepen si më poshtë:

Nr	Monedhat	2008	2009	2010	2011	2012	2013	2014	2015	2016
1	Kurs i këmbimit mesatar lek/USD	83.9	95	103.9	100.9	109.5	109.5	109.7	109.0	108.0
2	Kurs i këmbimit mesatar lek/EURO	122.8	131.6	137.7	140.5	139.0	139.9	139.5	140.0	140.4

- Dokumenti i Programit Buxhetor Afatmesëm 2014-2016, dërgohet në këshillin e njësisë së qeverisjes vendore në muajin qershor.

- Brenda datës 1 qershor çdo njësi e qeverisjes vendore duhet të dërgojë në Ministrinë e Financave, me shkrim dhe në rrugë elektronike, formularin nr.1 "Parashikimi i të ardhurave për periudhën 2014-2016", dhe formularin nr.2 "Parashikimi i shpërndarjes së burimeve financiare për periudhën 2014-2016", të shoqëruar me një relacion për mënyrën e llogaritjes së PBA-së.

5. Mënyrat e llogaritjes së transfertave, të pakushtëzuara dhe të kushtëzuara për njësitë e qeverisjes vendore



5.1 Transferta e pakushtëzuar

- Kriteret dhe koeficientët e formulës së shpërndarjes së transfertës së pakushtëzuar për vitet 2014-2016 do të jenë po ata të vitit 2013. Në përlllogaritjen e formulës së transfertës së pakushtëzuar për vitin 2013, është marrë si kriter numri i popullsisë sipas Census-it.

- Në bazë të shifrave të mësipërme të këtij udhëzimi, çdo njësi e qeverisjes vendore mund të bëjë në mënyrë individuale llogaritjen e nivelit të transfertës së pakushtëzuar.

Shembuj mbi llogaritjen e transfertës së pakushtëzuar

Koeficientët dhe metodika e përdorur më poshtë janë ato të vitit 20XX, e cila do jetë e vlefshme edhe për llogaritjet e periudhës 20XX-20XX.

Grandi i përgjithshëm

Kriteri i popullsisë $70\% = 8,855$ milion lekë

Kriteri i sipërfaqes së $15\% = 1,897$ milion lekë

komunës

Kriteri i shërbimeve $15\% = 1,898$ milion lekë

urbane të bashkisë

Llogaritja e transfertës së pakushtëzuar për bashkinë X

Informacion i përgjithshëm:

- Popullsia 56 297 banorë,

- Të ardhura nga taksat e veta (taksa e biznesit të vogël + taksa e mjeteve të përdorura) në Bashkinë X janë 1,200 lekë/frymë,

- Të ardhura nga taksat e veta (taksa e biznesit të vogël + taksa e mjeteve të përdorura) në shkallë kombëtare janë 701 lekë/frymë,

- Popullsia në shkallë kombëtare 4,268,984 banorë,

- Popullsia urbane gjithsej 2,350,090 banorë

Llogaritja e grantit të përgjithshëm

1. Popullsia (56,297 banorë/4,268,984 banorë në shkallë kombëtare) = 0.0131 koeficienti i popullsisë. Nga kriteri i popullsisë bashkia X përfiton (0.0131 x 8,855 milionë lekë) = 116,774 mijë lekë,

2. Pjesa që i takon nga koeficienti i shërbimit urban (56,297 banorë/(2,350,984 popullsi që jeton në zonat urbane në shkallë kombëtare) = 0.0239 koeficienti i shërbimeve urbane. Nga kriteri i shërbimeve urbane kjo bashki përfiton (0.0239 x 1,898 milionë lekë) = 45,449 mijë lekë. Bashkia X, nga aplikimi i kriterëve të mësipërme përfiton grand të përgjithshëm (116,774 + 45,449) = 162,223 mijë lekë.

Ekuilizimi fiskal

3. Kapaciteti fiskal nga taksa e biznesit të vogël dhe taksa e automjeteve është 1,200 lekë/frymë.

Mesatarja në shkallë kombëtare është 701 lekë/frymë. Diferenca në krahasim me atë në shkallë kombëtare (1,200-701) = +499 lekë/frymë. Çdo bashki dhe komunë me një të ardhur për frymë më të madhe se mesatarja nacionale, do të kontribuojë 25% të diferencës për ekualizim fiskal, në raport me popullsinë e saj; kjo shumë zbritet nga llogaritja fillestare e grantit. Çdo bashki dhe komunë që është më poshtë se sa mesatarja nacionale, do të kompensohet për 25% të kësaj difference në raport me popullsinë e saj; kjo shumë i shtohet llogaritjes fillestare të grantit. Në rastin konkret, Bashkia X do të kontribuojë për arsye të kapacitetit fiskal më të lartë se ajo në shkallë kombëtare me $((499 \times 56297 \text{ banorë}) / 1000) \times (25/100) = 28,092$ mijë lekë, që do thotë se grand i bëhet (162,223-28,092) = 134,131 mijë lekë.

Rregullimet tranzitore

4. Grandi i përgjithshëm pas kapacitetit fiskal duke i shtuar taksën e biznesit të vogël dhe taksën e automjeteve është 67,556 mijë lekë.

5. Grandi për vitin 20XX, pas kryerjes së kompensimeve dhe shtesave gjatë vitit është 130,250 mijë lekë.

6. Diferenca nga krahasimi me vitin 20XX, është $(134,131 - 130,250) = +3,881$ mijë lekë.

7. Kufiri i sipërm i rritjes është + 7%, në rastin konkret bashkia ka +3% dhe për rrjedhojë nuk i bën zbritje sepse është brenda mesatares në shkallë kombëtare.

8. Grandi i përgjithshëm i Bashkisë X është 134,131 mijë lekë.

Transferta e pakushtëzuar për këshillat e qarqeve

Transferta e pakushtëzuar për Qarqet është ndarë në dy pjesë:

· Grandi i përgjithshëm $(1,175 \times 99) \quad 99\% = 1,163$ milionë lekë

· Fondi i kompensimit për qarqet $(1,175 \times 1) \quad 1\% = 12$ milionë lekë

Grandi i përgjithshëm

Shuma fikse $10\% = 11,630$ mijë lekë (për çdo qark)

Popullsia $28\% = 32,563$ mijë lekë

Treguesi gjeografik $30\% = 34,890$ mijë lekë

Koeficienti i rrugës $32\% = 34,890$ mijë lekë

· Llogaritja e transfertës së pakushtëzuar për qarkun X

Informacion i përgjithshëm:

· Popullsia 112,050 banorë,

· Popullsia në shkallë kombëtare 4,268,984 banorë,

· Treguesi gjeografik "M"(malore),

· Pesha gjeografike "5",

· Pesha gjeografike gjithsej në shkallë kombëtare "32",

· Gjatësia e rrugëve rurale rajonale që menaxhohen nga 12 qarqet 4289 km,

· Gjatësia e rrugëve rurale rajonale që menaxhohen nga Qarku X 346 km.

Llogaritja e grandit të përgjithshëm

1. Shuma fikse që i takon këtij qarku $(11,630 \text{ mijë lekë} / 12 \text{ qarqe}) = 1,358$ mijë lekë.

2. Pjesa që i takon nga popullsia $(112050 \text{ banorë} / 4,268,984 \text{ banor në shkallë kombëtare}) = 0.02624$ koeficienti i popullsisë. Nga kriteri i popullsisë, qarku X përfiton $(0.02624 \times 32,563 \text{ mijë}) = 8,546$ mijë lekë.

3. Pjesa që i takon nga treguesi gjeografik $(5/32) = 0.1563$ koeficienti gjeografik. Nga kriteri i treguesit gjeografik, qarku X përfiton $(0.1563 \times 34,890 \text{ mijë lekë}) = 1,964$ mijë lekë.

4. Pjesa që i takon nga koeficienti i rrugës $(346/4289) = 0.0807$ koeficienti rrugës. Nga kriteri i koeficientit të rrugës, qarku X përfiton $(0.0807 \times 34,890 \text{ mijë lekë}) = 2,815$ mijë lekë.

Qarku X përfiton grand $(1,358 + 8,546 + 1,964 + 2,815) = 14,683$ mijë lekë.

5.2. Transferta e kushtëzuar

- Transferta e kushtëzuar parashikohet në programin buxhetor afatmesëm 2014-2016, për financimin e shpenzimeve për funksionet e deleguara. Sipas akteve ligjore në fuqi, funksione të deleguara në pushtetin vendor janë, shërbimi e gjendjes civile, mbrojtja dhe administrimi i tokës, Qendra e Regjistrimit të Bizneseve.

- Shuma e transfertave të kushtëzuara do të jetë rezultat i shpenzimeve sipas artikujve për çdo aktivitet që kryhet në zbatim të funksioneve të deleguara, ose të përbashkëta. Parashikimi i zërave të pagave, sigurimeve shoqërore, dhe shpenzimeve operative e të mirëmbajtjes, do të bëhen në përputhje me aktet ligjore në fuqi për zërat përkatës.

6. Ndjekja e procesit dhe mbështetja këshillimore

- Ministria e Financave, në kuadër të mbështetjes këshillimore për përgatitjen e PBA 2014-2016, vë në dispozicion për çdo njësi të qeverisjes vendore, adresat e e-mailit:

fbrahimi@minfin.gov.al, dhe jmemaj@minfin.gov.al



- Bashkëlidhur gjeni: formularin nr.1 “Parashikimi i të ardhurave për periudhën 2014-2016”, formularin nr.2 “Parashikimi i shpërndarjes së burimeve financiare për periudhën 2014-2016”, relacionin, dhe një shembull për mënyrën e plotësimit të relacionit.

7. Të tjera

- Për sqarime të mëtejshme përveç këtij udhëzimi mund të përdorni për analogji edhe udhëzimin nr.9, datë 22.2.2013 “Për përgatitjen e buxhetit afatmesëm 2014-2016”.

MINISTERI FINANCEVE
Ridvan Bode

Nr	Emertimi i të Ardhurave Tatimore	Fakti 2012	Të ardhura për frymë	I pritshmi 2013	Të ardhura për frymë	2014	Të ardhura për frymë	2015	Të ardhura për frymë	2016	Të ardhura për frymë
I.	Të ardhura nga taksa										
1	Taksa vendore mbi biznesin e vogël										
2	Taksa mbi Ndërtesat										
3	Taksa mbi token bujqësore										
4	Taksa e fjetjes në hotel										
5	Taksa e ndikimit në infrastrukturë nga ndërtimet e reja										
6	Taksa mbi kalimin e të drejtës së pronësisë për pasuritë e paluajtshme										
7	Taksa vjetore e mjeteve të përdorura										
8	Taksa për zënieën e hapësirave publike										
9	Taksa e tabelës										
10	Taksa të përkohshme										
11	Taksa e rentës minerare										
II.	Të ardhura nga tarifat										
1	Tarifa për pastrim										
2	Tarifa për hapësira publike										
3	Tarifa ujit të pijshëm										
4	Tarife ndriçimi rrugor										
5	Tarife table										
6	Tarife gjelbërimi										
7	Tarifa për Reklame										
8	Tarifa parkimi										
9	Tarifa për therjen e bagëtive										
10	Tarife për shërbime të tjera administrative										
11	Tarife për shërbime sociale (arsim parashkollor konvikte)										
12	Sporte dhe kultura										
13	Tarifa të tjera										
III.	Të ardhura nga shitja e pronës dhe dhënia me qera										
1	Shitje Ndërtese										
2	Shitje Troje										
3	Shitje të pronave të ndryshëm										
4	Qera Troje										
5	Qera nga Ndërtesat										
6	Interesa nga të ardhurat										



IV.	Të ardhura nga ndërmarrjet e ndryshme											
V.	Të ardhura të tjera											
1	Transferta e Pakushtëzuar											
2	Kredi dhe Hua											
3	Dhurata dhe sponsorizime te ndryshme											
4	Te ardhura nga gjobat											
5	Te ardhurat te trasheguara nga viti i kaluar											
VI	Totali i te ardhurav te veta (I+II+III+IV)											
VII	Te ardhura te kushtezuara											
1	Transferta te kushtezuara											
2	Fondi i Zhvillimit te Rajoneve											
VIII	Te ardhurat gjithsej (VI+ VII)											

Nëpunësi Autorizues
()

Njësia Vendore _____ Formulari 2
Parashikimi i Shpërndarjes së Burimeve Financiare për periudhën 2014-2016

Ne mijë leke

N r	Funksionet	Fakt 2012				I pritshmi 2013				2014				2015				2016			
		Shp. për personel in	Shp. te tjera korren te	Shp. për Invest	Tota li	Shp. për personel in	Shp. te tjera korren te	Shp. për Invest	Tota li	Shp. për personel in	Shp. te tjera korren te	Shp. për Invest	Tota li	Shp. për personel in	Shp. te tjera korren te	Shp. për Invest	Tota li	Shp. për personel in	Shp. te tjera korren te	Shp. për Invest	Tota li
1	Administrata																				
2	Pastrim Gjellbërim																				
3	Ujësjellës Kanalizime																				
4	Menaxhimi Rrugor																				
5	Transporti Publik																				
6	Zhvillimi i Turizmit																				
7	Strehimi dhe Urbanistika																				
8	Ndriçimi Publik																				
9	Zhvillimi ekonomik																				
10	Mbrojtja dhe Zhvillimi i Pyjeve lokale																				
11	Mbrojtja e mjedisit																				
12	Zhvillimi i Sportit																				
13	Programe Kulturele																				
14	Kujdesi Social																				
15	Arsimi																				
16	Shëndetësia																				
17	Emergjencat Civile																				
18	Shërbimi borxhit afat-shkurtër																				
19	Shërbimi i borxhit afat-gjate																				
20	Shërbime te tjera publike																				
	Totali																				

Nëpunësi Autorizues

()



UDHËZIM
Nr. 1, datë 26.2.2013

**PËR KOMPENSIMIN DHE ASISTENCËN E PASAGJERËVE NË RASTIN E
MOSPRANIMIT NË BORD TË AVIONIT DHE ANULIMIT OSE VONESËS GJATË
FLUTURIMEVE**

Në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në zbatim të nenit 138 pika 4 e ligjit nr. 10 040, datë 22.12.2008 “Kodi Ajror i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar dhe në përputhje me ligjin nr. 9658, datë 18.12.2006 “Për ratifikimin e marrëveshjes shumëpalëshe ndërmjet Komunitetit Europian dhe shteteve anëtare të tij, Republikës së Shqipërisë, Bosnjës dhe Hercegovinës, Republikës së Bullgarisë, Republikës së Kroacisë, Republikës së Maqedonisë, Republikës së Islandës, Republikës së Malit të Zi, Mbretërisë së Norvegjisë, Republikës së Rumanisë, Republikës së Serbisë dhe Misionit Administrativ të Përkohshëm të Kombeve të Bashkuara në Kosovë, për krijimin e një Zone të Përbashkët të Aviacionit Europian”,

UDHËZOJ:

Neni 1

Qëllimi

Ky udhëzim ka për qëllim vendosjen e kriterëve bazë, për të siguruar një standard minimal të të drejtave të pasagjerëve në rastet kur:

- a) u refuzohet hipja në avion kundër dëshirës së tyre;
- b) fluturimi i tyre anulohet;
- c) fluturimi i tyre vonohet.

Neni 2

Përkufizime

Për qëllim të këtij udhëzimi:

- a) “transportues ajror” nënkupton një sipërmarrës të transportit ajror që zotëron një licencë operimi të vlefshme;
- b) “transportues ajror operues” nënkupton një transportues ajror, i cili kryen ose ka si qëllim të kryejë një fluturim, sipas një kontrate me pasagjerin, si dhe çdo transportues ajror që kryen ose ka si qëllim të kryejë një fluturim, në emër të një personi tjetër juridik ose fizik, që ka një kontratë me pasagjerin në fjalë;
- c) “transportues ajror të ZPEA-së” nënkupton një transportues ajror me një licencë të vlefshme operimi, të lëshuar nga autoriteti kompetent në përputhje me legjislacionin në fuqi për këtë qëllim, sipas përcaktimeve të marrëveshjes shumëpalëshe;
- d) “operator turistik” nënkupton, me përjashtim të një transportuesi ajror, një organizues (agjenci) që ofron dhe shet paketa turistike, vetë apo nëpërmjet një përfaqësuesi;
- e) “paketë” nënkupton kombinimin e parapërgatitur e jo më pak se dy elementeve të mëposhtme, e cila shitet ose ofrohet për t’u shitur me një çmim gjithëpërfshirës, me kusht që shërbimi të ofrohet për një periudhë më të gjatë se 24 orë ose të përfshijë një akomodim për një natë.

Elementet e nevojshme janë:

- transport;
- akomodim;

- shërbime të tjera turistike jondihmëse për transportin ose akomodimin dhe të rëndësishme për një pjesë të mirë të paketës;

f) “biletë” nënkupton një dokument të vlefshëm që të jep të drejtën e udhëtimit ose diçka të barasvlershme jo në formë letre, përfshirë formën elektronike të lëshuar ose autorizuar nga një transportues ajror ose agjenti i tij i autorizuar;

g) “rezervim” nënkupton faktin që pasagjeri ka një biletë, ose provë tjetër, e cila tregon se rezervimi është pranuar dhe regjistruar nga ana e transportuesit ajror ose operatorit turistik;

h) “destinacioni final” nënkupton destinacionin e përcaktuar në biletë ose në rastin e fluturimeve të lidhura direkt, destinacionin e fundit të udhëtimit;

fluturimet lidhëse alternative nuk do të merren në konsideratë nëse respektohet koha e planifikuar e mbërritjes;

i) “person me aftësi lëvizëse të kufizuar” nënkupton çdo person, lëvizja e të cilit zvogëlohet kur përdor transportin për shkak të ndonjë paaftësie fizike (ndijimore apo lëvizëse, e përkohshme apo e përhershme), paaftësive intelektuale, të moshës ose çdo shkak të çdo paaftësie tjetër gjendja e të cilit kërkon vëmendje të veçantë dhe përshtatje ndaj nevojave të personit lidhur me shërbimet e vëna në dispozicion të pasagjerëve;

j) “refuzim i hipjes në bord të avionit” nënkupton refuzimin për të transportuar pasagjerë edhe pse ata janë paraqitur sipas kushteve të përcaktuara në nenin 3(2), me përjashtim të rasteve kur ekzistojnë kushte të arsyeshme për të refuzuar hipjen, siç mund të jenë:

- arsye shëndetësore;

- arsye të sigurisë ose mbrojtjes; ose

- për shkak të mungesës së dokumentacionit të duhur të udhëtimit;

k) “vullnetar” nënkupton një person, i cili është paraqitur për të hipur sipas kushteve të përcaktuara në nenin 3(2) dhe i përgjigjet pozitivisht thirrjes së transportuesit ajror për pasagjerët, të cilët heqin dorë nga rezervimi në shkëmbim të përfitimit;

l) “anulimi” nënkupton mosoperimin e një fluturimi, i cili ishte planifikuar më parë dhe në të cilin të paktën një vend rezulton i rezervuar.

Neni 3

Fusha e zbatimit

1. Ky udhëzim do të zbatohet për:

a) pasagjerët që nisen nga një aeroport të vendosur në territorin e RSH-së apo të ZPAE-së, sipas përcaktimeve të marrëveshjes shumëpalëshe;

b) për pasagjerët që nisen nga një aeroport i një vendi të tretë për në një aeroport të vendosur në RSH apo të ZPAE-së, nëse transportuesi ajror i fluturimit në fjalë është një transportues ajror shqiptar apo i ZPAE-së, sipas përcaktimeve të marrëveshjes shumëpalëshe, me përjashtim të rasteve kur ata kanë marrë kompensim dhe u është ofruar asistencë në atë vend të tretë.

2. Neni (3.1) zbatohet me kusht që pasagjerët:

a) të kenë një rezervim të konfirmuar, përveç rasteve të anulimeve të përmendura në nenin 5, për fluturimin në fjalë dhe të paraqiten te kontrolli i biletave, ashtu siç parashikohet dhe në kohën e paracaktuar dhe me shkrim (përfshirë mënyrën elektronike), nga ana e transportuesit ajror, operatorit turistik ose një agjenti të autorizuar, ose në rast se nuk është përcaktuar koha, jo më vonë se 45 minuta para kohës së nisjes së publikuar;

b) të jenë transferuar nga një transportues ajror ose operator turistik, prej fluturimit për të cilin ato kishin një rezervim të një fluturimi tjetër, pavarësisht nga shkaku.



3. Ky udhëzim nuk do të aplikohet për pasagjerët që udhëtojnë falas ose me një tarifë të ulët, e cila nuk është në dispozicion të drejtpërdrejtë të publikut. Megjithatë, udhëzimi do të aplikohet për pasagjerët që zotërojnë bileta të lëshuara nga ana e një transportuesi ajror ose operatori turistik, në bazë të një programi të transportuesit të rregullt ose programeve të tjera komerciale.

4. Ky udhëzim aplikohet vetëm për pasagjerët të transportuar me anë të mjetit ajror/avionit të motorizuar me krahë të fiksuar.

5. Ky udhëzim aplikohet për çdo transportues ajror operues, i cili siguron transport për pasagjerë të parashikuar sipas paragrafëve 1 dhe 2. Kur një transportues ajror operues, i cili nuk zotëron një kontratë me pasagjerin, realizon detyrime në bazë të këtij udhëzimi, transportuesi konsiderohet se vepron në këtë mënyrë në emër të personit që zotëron një kontratë me pasagjerin në fjalë.

6. Ky udhëzim nuk aplikohet në rastet kur një paketë turistike (udhëtim i organizuar) anulohet për arsye që nuk kanë të bëjnë me anulimin e fluturimit.

Neni 4

Refuzimi i hipjes në bord të avionit

1. Kur një transportues ajror, në mënyrë të arsyeshme mendon të refuzojë hipjen në një avion të pasagjerëve, ai së pari njofton për vullnetarë që të heqin dorë nga rezervimi i tyre, në shkëmbim të përfitimit sipas kushteve, të cilat do të përcaktohen ndërmjet pasagjerit në fjalë dhe transportuesit ajror operues. Vullnetarët asistohen sipas nenit 8 dhe asistenca në fjalë konsiderohet plotësuese, përveç përfitimeve të përmendura në këtë paragraf.

2. Nëse një numër i pamjaftueshëm vullnetarësh paraqitet dhe nuk lejon pasagjerët e mbetur me rezervime të hipin në avion, transportuesi ajror operues mundet atëherë t'u refuzojë hipjen pasagjerëve kundrejt dëshirës së tyre.

3. Nëse hipja u refuzohet pasagjerëve kundër dëshirës së tyre, transportuesi ajror operues menjëherë i kompenson ata siç parashikohet në nenin 7 dhe i asiston ata, sipas parashikimeve të neneve 8 dhe 9.

Neni 5

Anulimi

1. Në rastin e anulimit të fluturimit, pasagjerëve në fjalë:

a) u ofrohet asistencë nga transportuesi ajror operues në përputhje me nenet 8; dhe

b) u ofrohet asistencë nga ana e transportuesit ajror operues në përputhje me nenin 9(1)(a) dhe 9(2), si dhe në rastin e kalimit të një linje tjetër (itinerar i ri), kur koha e pritshme për nisje në fluturimin e ri është të paktën një ditë pas kohës së nisjes që ishte planifikuar në fluturimin e anuluar, asistenca parashikohet nga nenet 9(1)(b) dhe 9(1)(c); dhe

c) të gëzojnë të drejtën e kompensimit nga transportuesi ajror operues në përputhje me nenin 7, me përjashtim të rasteve kur:

i) pasagjerët janë informuar për anulimin të paktën dy javë para kohës të planifikuar të nisjes; ose

ii) pasagjerët janë informuar mbi anulimin ndërmjet dy javëve dhe shtatë ditëve para kohës së planifikuar të nisjes dhe u është ofruar kalim te një linjë tjetër, duke bërë të mundur nisjen e tyre jo më shumë se 2 orë para kohës së planifikuar për nisje dhe duke bërë të mundur mbërritjen në destinacionin e tyre të fundit jo më vonë se katër orë nga koha e planifikuar për mbërritje; ose

iii) janë informuar për anulimin më pak se shtatë ditë para kohës së planifikuar të nisjes dhe u është ofruar kalim te një linjë tjetër, duke bërë të mundur nisjen e tyre jo më shumë se një orë para kohës së planifikuar të nisjes dhe duke bërë të mundur arrijtjen në destinacionin e fundit jo më vonë se 2 orë nga koha e planifikuar e mbërritjes.

2. Kur pasagjerët informohen për anulim, do t'u jepet një shpjegim në lidhje me alternativën e mundshme të transportit.

3. Një transportues ajror operues nuk është i detyruar të paguajë kompensim në përputhje me nenin 7, nëse ai mund të provojë se anulimi është shkaktuar nga rrethana të jashtëzakonshme, të cilat nuk mund të mënjanoreshin edhe sikur të ishin marrë të gjitha masat e arsyeshme.

4. Detyrimi për të ruajtur provat lidhur me pyetjet, nëse dhe kur është informuar pasagjeri për anulimin e fluturimit, i takon transportuesit ajror operues.

Neni 6

Vonesa

1. Kur një transportues ajror operues ka arsye të mendojë se një fluturim do të vonohet përtej kohës së planifikuar të nisjes:

a) për dy orë ose më shumë në rastin e fluturimeve prej 1500 km ose më pak; ose

b) për tri orë ose më shumë në rastin e të gjitha fluturimeve brenda ZPEA-së prej më shumë se 1500 km dhe të gjitha fluturimet e tjera ndërmjet 1500 dhe 3500 km; ose

c) për katër orë ose më shumë në rastin e të gjitha fluturimeve që nuk mbulohen nga (a) ose (b);

pasagjerëve do t'u ofrohet nga ana e transportuesit ajror operues:

i) asistencë e specifikuar në nenet 9(1)(a) dhe 9(2); dhe

ii) kur koha e supozuar e arsyeshme e nisjes është të paktën dita që pason pas kohës së nisjes së njoftuar më parë, asistencë që specifikohet në nenet 9(1)(b) dhe 9(1)(c); dhe

iii) kur vonesa është të paktën pesë orë, asistencë e specifikuar në nenin 8(1)(a).

2. Në çdo rast, asistenca do të ofrohet brenda limitit kohor të përcaktuar më sipër për sa i përket çdo distance.

Neni 7

E drejta e kompensimit

1. Për të gjitha referencat që i bëhen këtij neni, pasagjerët do të përfitojnë kompensim që arrin në:

a) 250 euro për të gjitha fluturimet prej 1500 km ose më pak;

b) 400 euro për të gjitha fluturimet brenda ZPEA-së, më shumë se 1500 km, dhe për të gjitha fluturimet e tjera ndërmjet 1500 dhe 3500 km;

c) 600 euro për të gjitha fluturimet që nuk janë parashikuar sipas (a) ose (b).

Në përcaktimin e distancës, do të merret për bazë destinacioni i fundit në të cilin refuzimi ose anulimi do të vonojë mbërritjen e pasagjerit pas kohës së planifikuar.

2. Transportuesi ajror operues mund të zvogëlojë kompensimin e parashikuar në pikën e parë me 50%, kur pasagjerëve u ofrohet një linjë tjetër (itinerar i ri) për në destinacionin e tyre final me anë të një fluturimi alternativ sipas nenit 8, koha e mbërritjes të së cilës nuk e tejkalon kohën e mbërritjes së planifikuar sipas rezervimit fillestar.

a) për dy orë, në lidhje me të gjithë fluturimet prej 1500 km ose më pak; ose

b) për tri orë, në lidhje me të gjitha fluturimet brenda ZPEA-së, më shumë se 1500 km, dhe për të gjitha fluturimet e tjera ndërmjet 1500 dhe 3500 km; ose

c) për katër orë në lidhje me të gjitha fluturimet që nuk parashikohen në (a) ose (b).

3. Kompensimi i përmendur në paragrafin 1 do të paguhet në dorë, me transfertë bankare elektronike, me mandat bankar ose çek banke ose me një marrëveshje të nënshkruar prej pasagjerit, me kuponë udhëtimi ose shërbime të tjera.

4. Distancat e dhëna në paragrafin 1 dhe 2 do të maten sipas metodës së rrugës më të gjatë.



Neni 8

E drejta e rimbursimit ose kalimi në një linjë tjetër

1. Në rastet e referimeve të bëra ndaj këtij neni, pasagjerëve do t'u ofrohet të zgjedhin ndërmjet:

a) rimbursimit brenda 7 ditëve, sipas mënyrës së parashikuar në nenin 7(3), të vlerës së plotë të biletës me çmimin e blerjes, për pjesën ose pjesët e udhëtimit të pakryer, dhe për pjesën ose pjesët pothuajse të realizuara, nëse fluturimi nuk i shërben më ndonjë qëllimi lidhur me planin fillestar të udhëtimit të pasagjerit dhe me planin e udhëtimit fillestar të pasagjerëve, së bashku me:

- një fluturim kthimi drejt pikës së parë të nisjes, me mundësinë më të afërt;

b) itinerar të ri (kalim te një linjë tjetër), në bazë të kushteve të krahasueshme të transportit, drejt destinacionit final, në rastin më të parë; ose

c) itinerar të ri (kalim te një linjë tjetër), në bazë të kushteve të krahasueshme të transportit, drejt destinacionit final, në një datë më të mëvonshme, sipas dëshirës së pasagjerit, në varësi të vendeve të lira.

2. Paragrafi 1(a), gjithashtu, aplikohet për pasagjerët, fluturimet e të cilëve përbëjnë pjesë të një pakete, përveç të drejtës për rimbursim, kur kjo e drejtë buron nga rregullat mbi paketat turistike.

3. Në rastin kur një, qytet ose rajon disponon disa aeroporte, një transportues ajror operues i ofron pasagjerit një fluturim drejt një aeroporti alternativ të saj prej atij të rezervuar, transportuesi ajror operues do të mbulojë koston e transferimit të pasagjerit nga aeroporti alternativ në fjalë ose drejt aeroportit të rezervuar ose drejt një destinacioni tjetër të afërt të rënë dakord me pasagjerin.

Neni 9

E drejta për përkujdesje

1. Sipas këtij neni, pasagjerëve u ofrohet falas:

a) ushqim dhe pije freskuese në mënyrë të arsyeshme në varësi të kohës së pritjes.

b) akomodim në hotel në rastet kur:

- qëndrimi për një ose më shumë net është i nevojshëm; ose

- një qëndrim shtesë nga ai që mendonte pasagjeri është i nevojshëm;

c) transporti ndërmjet aeroportit dhe vendit të akomodimit (hotel ose të tjera).

2. Për më tepër, pasagjerëve u ofrohen falas dy telefonata, mesazh me teleks ose faks, ose e-mail.

3. Në zbatim të këtij neni, transportuesi ajror operues do t'u kushtojë vëmendje të veçantë nevojave të personave me lëvizje të kufizuar dhe çdo personi që shoqëron ata, si dhe nevojave të fëmijëve të pashoqëruar.

Neni 10

Ngritja dhe ulja e kategorisë

1. Nëse një transportues ajror operues vendos një pasagjer në një kategori më të lartë sesa kategoria e përcaktuar në biletë, ai mund të mos kërkojë ndonjë pagesë suplementare.

2. Nëse një transportues ajror operues vendos një pasagjer në një kategori më të ulët sesa kategoria e përcaktuar në biletë, ai duhet brenda shtatë ditëve sipas mënyrave të parashikuara në nenin 7(3) të rimbursojë:

a) 30 % të çmimit të biletës për të gjitha fluturimet prej 1500 km ose më pak; ose

b) 50 % të çmimit të biletës për të gjitha fluturimet brenda ZPEA-së prej më shumë se 1500 km, përveç fluturimeve ndërmjet territorit të ZPEA-së dhe për të gjitha fluturimet ndërmjet 1500 dhe 3500 km; ose

c) 75 % të çmimit të biletës për të gjitha fluturimet që nuk parashikohen në (a) dhe (b), përfshirë fluturimet mes territorit të ZPEA-së.

Neni 11

Personat me lëvizshmëri të kufizuar ose nevoja të veçanta

1. Transportuesi ajror operues do t'i japë prioritet transportit të personave me lëvizshmëri të kufizuar dhe çdo personi tjetër ose qenve të certifikuar të shërbimit që i shoqërojnë, si dhe fëmijëve të pashoqëruar.

2. Në rastet e refuzimit të hipjes në avion, anulimit dhe vonesave të çdo lloji kohëzgjatjeje, personat me aftësi të kufizuar dhe çdo person që i shoqëron ata, si dhe fëmijët e pashoqëruar, gëzojnë të drejtën për përkujdesje sipas nenit 9 sa më shpejt të jetë e mundur.

Neni 12

Kompensime të mëtejshme

1. Ky udhëzim do të aplikohet pa cenuar të drejtat e pasagjerit për kompensim të mëtejshëm. Kompensimi i dhënë sipas këtij udhëzimi mund të zbritet nga kompensimi në fjalë.

2. Paragrafi 1 nuk do të zbatohet për pasagjerët, të cilët kanë hequr dorë vullnetarisht nga rezervimi sipas nenit 4(1).

Neni 13

E drejta e kompensimit

1. Në rastet kur transportuesi ajror operues paguan kompensimin ose përmbush detyrimet e ngarkuara sipas këtij udhëzimi, asnjë klauzolë e këtij udhëzimi nuk mund të interpretohet si kufizim i së drejtës së transportuesit për të kërkuar kompensim nga një person, përfshirë palët e treta, në përputhje me ligjin e aplikueshëm.

2. Në veçanti, ky udhëzim nuk kufizon të drejtën e transportuesit ajror operues për të kërkuar rimbursim nga një operator turistik ose personi tjetër, me të cilin transportuesi ajror operues ka një kontratë.

3. Në mënyrë të ngjashme asnjë klauzolë e këtij udhëzimi nuk mund të interpretohet si kufizim i së drejtës të një operatori turistik ose një pale të tretë, por jo një pasagjer, me të cilët transportuesi ajror operues ka një kontratë për të kërkuar rimbursim ose kompensim nga transportuesi ajror operues në përputhje me ligjet përkatëse.

Neni 14

Detyrimi për të informuar pasagjerët për të drejtat e tyre

1. Transportuesi ajror operues duhet të sigurojë që në kontrollin e biletave të ketë një njoftim të lexueshëm qartë, i cili duhet të ekspozohet në një mënyrë të dallueshme për pasagjerët, ku të përmbahet teksti i mëposhtëm: “Nëse juve ju refuzohet hipja në avion ose nëse fluturimi juaj anulohet ose vonohet të paktën dy orë, pyesni te kontrolli i biletave për rregulloren ku shprehen të drejtat tuaja, veçanërisht të drejtat që kanë të bëjnë me kompensimin dhe asistencën”.

2. Transportuesi ajror operues, duhet:

- t'i paraqesë çdo pasagjeri të dëmtuar nga refuzimi i hipjes në avion ose anulimi i fluturimit një njoftim me shkrim ku përcaktohen rregullat për kompensim dhe asistencë, sipas përcaktimeve të këtij udhëzimi;

- t'i paraqesë një njoftim të ngjashëm, çdo pasagjeri të dëmtuar nga vonesa prej të paktën 2 orësh;



- t'i sigurojë çdo pasagjeri në një formë të shkruar informacion të hollësishëm për kontaktim me organin kompetent sipas nenit 16.

3. Për sa u përket personave që nuk shikojnë dhe me shikim të dëmtuar do të aplikohen nenet e këtij udhëzimi, duke përdorur mënyra alternative të përshtatshme.

Neni 15

Ndalimi i shmangies

1. Detyrimet ndaj pasagjerëve në zbatim të këtij udhëzimi nuk mund të shmangen nëpërmjet derogimeve apo një klauzole kufizuese në kontratën e transportit, mes pasagjerëve dhe operatorëve.

2. Në rast se është aplikuar një klauzolë kufizuese ose derogim në kontratën e transportit në disfavor të pasagjerit, ose nëse pasagjeri nuk është informuar saktë mbi të drejtat e tij dhe për këtë arsye ka pranuar një kompensim më të ulët sesa kompensimi i parashikuar në këtë udhëzim, pasagjeri ka të drejtë të marrë masat e nevojshme para organeve dhe gjykatave kompetente me qëllim përfitimin e kompensimit shtesë.

Neni 16

Organet kompetente

1. Autoriteti i Aviacionit Civil është autoriteti kompetent për zbatimin e këtij udhëzimi në lidhje me fluturimet që nisen nga Shqipëria apo nga vendet e treta jashtë ZPAE-së dhe mbërrijnë në Shqipëri.

2. Kur çmohet e arsyeshme, Autoriteti i Aviacionit Civil, merr masa të nevojshme për të siguruar respektimin e të drejtave të pasagjerëve.

3. Pa cenuar nenin 12, çdo pasagjer mund të paraqesë ankimim në Autoritetin e Aviacionit Civil, ose çdo autoritet të përcaktuar nga një shtet anëtar i ZPEA-së, sipas përcaktimeve të marrëveshjes shumëpalëshe, në lidhje me çdo shkelje të pretenduar, sipas përcaktimeve të këtij udhëzimi për çdo operim nga aeroportet e vendosura në territorin e Republikës së Shqipërisë apo të një vendi të ZPEA-së, ose që ka të bëjë me çdo fluturim nga një vend i tretë jashtë ZPAE-së, për në territorin shqiptar apo të vendit të ZPEA-së, sipas përcaktimeve të marrëveshjes shumëpalëshe.

4. Sanksionet e aplikuara për shkeljen e dispozitave të kësaj rregulloreje duhet të jenë efektive, proporcionale dhe të argumentuara.

Neni 17

Ngarkohet AAC-ja të raportojë në Komitetin e Përbashkët në lidhje me zbatimin e kësaj rregulloreje.

Neni 18

1. Udhëzimi nr. 17, datë 15.10.2008 "Për kompensimin dhe asistencën e pasagjerëve në rastin e mospranimit në bord të avionit dhe anulimit ose vonesës gjatë fluturimeve", shfuqizohet.

2. Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I PUNËVE PUBLIKE DHE TRANSPORTIT
Sokol Olldashi

UDHËZIM
Nr. 581/1, datë 6.2.2013

**PËR PËRCAKTIMIN E TARIFAVE TË SHËRBIMIT NË AUTORITETIN PORTUAL
DURRËS**

Në mbështetje të nenit 102 pika 4 të Kushtetutës, nenit 84 të ligjit nr. 9251, datë 8.7.2004 “Kodi Detar i Republikës së Shqipërisë”, Ministri i Financave dhe Ministri i Punëve Publike dhe Transportit, me propozim të Këshillit Drejtues të Autoritetit Portual Durrës, me vendimet nr. 17, datë 24.12.2012 dhe nr. 1, datë 28.1.2013,

UDHËZOJNË:

1. Tarifat për shërbimet në Autoritetit Portual Durrës, caktohen sipas lidhjes që i bashkëngjitet këtij udhëzimi dhe është pjesë përbërëse e tij. Niveli i tarifës për shërbimet është shprehur pa TVSH.

2. Institucioni përgjegjës për vjeljen e tarifave është Autoritetit Portual Durrës ose subjekte të autorizuar prej tij.

Ky udhëzim hyn në fuqi në datën 7.2.2013 dhe botohet në Fletoren Zyrtare në numrin më të parë të radhës.

Udhëzim nr. 1, datë 6.1.2012, ndryshuar me udhëzim nr. 3488/1, datë 23.8.2012, shfuqizohet.

MINISTRI I FINANCAVE
Ridvan Bode

MINISTRI I PUNËVE PUBLIKE DHE
TRANSPORTIT
Sokol Olldashi

TARIFAT
PORTI I DURRËSIT

Referenca ligjore

“Tarifat Porti i Durrësit” janë hartuar në përputhje me kërkesat e ligjit nr. 9251, datë 8.7.2004 “Kodi Detar i Republikës së Shqipërisë”, ligjit nr. 9130, datë 8.9.2003 “Për Autoritetin Portual Durrës”, kapitulli IV neni 35 e në vijim dhe vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 596, datë 10.9.2004 “Për miratimin e statusit të Autoritetit Portual Durrës dhe për riorganizimin e tij”.

1. Përcaktimi i tarifave portuale

Autoriteti Portual cakton tarifat për:

- anijet, mjetet e transportit dhe personat që përdorin portin;
- ngarkimin e mallrave në anije, shkarkimin e tyre, tregtimin detar brenda kufijve të portit dhe magazinimin në port;
- shërbimet që sigurohen nga Autoriteti Portual ose nga një operator i licencuar, ose një e drejtë e dhënë prej tij në lidhje me portin.

Autoriteti Portual Durrës cakton normën e interesit për pagesat e vonuara.

Përkufizimet e termave jepen si më poshtë:

i) “Arkëtimet” janë tarifat e portit dhe të ankorimit në skelë, si dhe arkëtimet e tjera që zbatohen ndaj personave dhe zotëruesve të anijeve, të ngarkesave dhe të mjeteve të transportit.



ii) “Pagesa të arkëtuara nga Autoriteti Portual” janë të gjitha pagesat e kryera nga operatorë ose agjentë të ndryshëm të mbledhura nga autoritetet portuale.

iii) “Tarifa ndaj anijes” është çdo pagesë e kërkuar nga Autoriteti Portual ose nga një operator i licencuar ndaj zotëruesit të anijes ose agjentit të tij.

iv) “Tarifa ndaj mallit” është çdo tarifë e vendosur nga Autoriteti Portual ose nga një operator i licencuar ndaj zotëruesit të mallit, ose agjencive të tyre.

v) “Mallrat” janë të gjitha të mirat materiale që përdoren për veprimtarinë tregtare përveç anijes.

2. Përgjegjësia për pagesat e tarifave

Tarifat dhe interesat për anijet dhe ngarkesat, paguhen nga zotëruesi ose personi që ka në ngarkim anijen, ose mallin dhe mblidhen nga Autoriteti Portual ose nga një operator i autorizuar.

Tarifat dhe interesi, për mjetet e transportit paguhen nga zotëruesi i mjetit dhe mblidhen nga Autoriteti Portual ose nga një operator i autorizuar.

3. Garancia e pagesës

1. Autoriteti Portual ose një operator i autorizuar ka të drejtën të mbajë anijen ose të ardhurat nga shitja e saj si garanci për shumën që anija detyrohet, dhe konkretisht kjo shumë ka lidhje me:

a) Tarifat dhe interesin që duhet të shlyejë anija për qëndrimin e saj ose për mallrat e ngarkuara në të.

b) Dëmtimin e pronës nga anija ose ekuipazhi i saj.

2. Autoriteti Portual ose një operator i autorizuar mund të marrë si garanci mallra për shumën që i duhet të paguajë anija për tarifat dhe interesin.

3. Kur mallrat e mbajtura për garanci janë mallra që prishen, Autoriteti Portual mund t'i shesë me çmim të arsyeshëm dhe të ardhurat kreditohen për të shlyer pagesën që duhet të paguhet për anijen dhe mallrat.

3. Paanësia

Kur cakton tarifat Autoriteti Portual ose operatorit të autorizuar, nuk i lejohet të shkelin barazinë e subjekteve përdoruese. Nuk përbën diskriminim nëse bëhen dallime në bazë të vëllimit të mallrave a të sasisë së të mirave që tregtohen apo mbi baza të tjera, që nga ana tregtare janë të pranueshme për një person të licencuar që ka të drejtën e caktimit të tarifave.

Çdo person i interesuar ka të drejtën e ankimit pranë drejtorit ekzekutiv kur mendon se janë bërë dallime në vendosjen e tarifave portuale.

4. Miratimi i tarifave portuale

Tarifat portuale miratohen nga Këshilli Drejtues i Autoritetit Portual në përputhje nën 15 të ligjit nr. 9130, datë 8.9.2003 “Për Autoritetin Portual”.

Miratimi i tarifave portuale bëhet në fund të çdo viti për vitin e ardhshëm kalendarik.

Tarifat portuale të miratuara nga Këshilli Drejtues i Autoritetit Portual, propozohen për miratim, sipas një udhëzimi të përbashkët të Ministrisë së Punëve Publike dhe Transportit dhe Ministrisë së Financave.

5. Hyrja në fuqi

Hyrja në fuqi e tarifave portuale përcaktohet në udhëzimin e përbashkët të Ministrisë së Financave dhe Ministrisë së Punëve Publike dhe Transportit “Për miratimin e tarifave portuale në APD për vitin 2013”.

6. Informimi

Tarifat portuale janë publike dhe përdoruesit e portit duhet të jenë gjithmonë të informuar për vendosjen e tarifave të reja apo rishikimin e atyre ekzistuese.

Informimi përfshin publikimin në gazetë ose Fletoren Zyrtare, si dhe publikimin në faqen e internetit të APD-së.

KAPITULLI 1 TARIFAT E PAGUESHME NGA PRONARI APO AGJENTI I ANIJES

1. TARIFAT E PORTIT DHE TË KANALIT

1.1 Përkufizime

1. Interpretim

a) “Tarifa e portit dhe e kanalit” do të thotë një tarifë për një anije, e cila përdor kanalën e lundrimit dhe basenin e portit në Portin e Durrësit;

b) “Pronar” do të thotë agjenti, marrësi me qira (*Charter*) ose zotëruesi i anijes;

c) “Port” do të thotë Porti i Durrësit i organizuar sipas ligjit të Autoritetit Portual;

d) “Traget” do të thotë anije vetëm për pasagjerë dhe automjete;

e) “Certifikata e madhësisë së tonazhit” do të thotë një certifikate e lëshuar nga një autoritet i matjes i njohur nga Autoriteti Portual i Durrësit, i cili vendos tonazhin e regjistruar bruto (GT) dhe detajet e tjera që kanë të bëjnë me anijen.

2. Aplikime

a) Këto tarifa aplikohen për ato anije, të cilat vijnë në ose përdorin Portin e Durrësit;

b) Këto tarifa janë të detyrueshme në të gjitha anijet, përfshirë anijet e zotëruara nga qeveria shqiptare ose nga qeveria e ndonjë vendi të huaj.

3. Tarifat

Tarifat e Portit dhe të Kanalit duhet të llogariten sipas njësive që janë vendosur në tabelën e mëposhtme:

a) Detyrimet për Portin dhe Kanalin të përcaktuara nga këto tarifa janë të pagueshme menjëherë nga pronari ose agjenti i anijes në përputhje me termat dhe kushtet e pagesës dhe mblidhen nga Autoriteti Portual Durrës ose përfaqësuesit e tij.

b) Detyrimet që lindin nga aplikimi i tarifës së Portit dhe të Kanalit, janë të pavarura (nuk kanë lidhje) nga detyrimet që lindin nga aplikimi i tarifave të tjera portuale.

4. Përmasat e anijes

a) Nëse janë dy tonazhe bruto ose përmasa të regjistruara në certifikatën e madhësisë së tonazhit, atëherë tonazhi ose përmasa më e madhe do të aplikohet për qëllimin e kësaj tarife.

b) Në qoftë se pronari i anijes e ka të pamundur të dorëzojë një certifikatë të madhësisë së tonazhit, Autoriteti Portual i Durrësit ose përfaqësuesi i tij mund të japë një vlerë të përafërt të tonazhit bruto ose dimensioneve të tjera që kanë të bëjnë me anijen. Tonazhi bruto ose përmasat e tjera të përcaktuara në këtë mënyrë, do të përdoren si tonazh bruto apo përmasa të regjistruara, për efekt të kësaj tarife.

5. Përrjashtime

1. Tarifat e Portit dhe kanalit nuk janë të pagueshme në lidhje me:

a) një luftanije ose ndonjë anije nën komandën e forcave shqiptare, ose një anije e një force vizitore;

b) një anije që i përket qeverisë shqiptare ose të një vendi të huaj dhe që nuk është e angazhuar në veprimtari tregtare;

c) një anije e angazhuar vetëm në peshkim dhe të tjera që e tregtojnë peshkun;

d) një anije që hyn në Portin e Durrësit për qëllim vendstrehimi në rast të një stuhie apo aksidenti;

e) një anije e përjashtuar nga aplikimi i tarifave, si rezultat i ndonjë marrëveshjeje ndërmjet Shqipërisë dhe një vendi të huaj.

2. Përrjashtime në rastet “double banking”

a) Për rastet e ngarkim-shkarkimit të anijeve me tonazh të madh, ku procesi nuk mund të kryhet i plotë në Kalatat e Portit dhe do të realizohet nëpërmjet operacioneve “double banking” në Radën e Portit të Durrësit;



i) Tarifa e portit dhe e kanalit dhe do të aplikohet vetëm një herë për secilën anije për të gjithë procesin.

1.2 Tarifat e Portit dhe Kanalit

1. Tarifat e Portit dhe Kanalit për anije për prekje	Njësia bazë	Tarifa (€)
a) Për tragete deri në 13 000 GT (T1)	€/GT	0.15
Për tragetet mbi 13 000 GT deri në 20 000 GT për çdo GT mbi 13 000 GT (T2)	€/GT	0.08
Për tragetet mbi 20 000 GT për çdo GT mbi 20 000 GT	€/GT	0.04
b) Tarifë për çdo prekje trageti, mbi 20 prekje në muaj, për çdo kompani për 1 (një) linjë operimi. Përfshihen nga aplikimi i kësaj tarife (b) periudha e pikut, 15 korrik deri më 15 shtator dhe 15 dhjetor deri më 15 janar. Për efekt të aplikimit të pikës “b”, “muaj” do të konsiderohet periudha nga data 15 e muajit deri në datën 15 të muajit pasardhës.		20 % zbritje
b) Për anije të tjera, përfshirë dhe anije Ro/Ro	€/GT	0.23

2. Tarifat e akostimit

2.1 Përkufizime

1. Interpretim

- “Tarifë vendakostimi/kalatë” do të thotë tarifë për një anije dhe/ose traget e cila, futet brenda dhe përdor ndonjë kalatë (vendakostim) në Portin e Durrësit;
- “Pronar” do të thotë agjenti, marrësi me qira ose zotëruesi i anijes;
- “Port” do të thotë porti Durrësit i organizuar sipas ligjit të Autoritetit Portual;
- “Certifikata e madhësisë së tonazhit” do të thotë një certifikatë e lëshuar nga një autoritet i matjes, i njohur nga Autoriteti Portual i Durrësit, i cili vendos tonazhin e regjistruar bruto (GT) ose/dhe detajet e tjera që kanë të bëjnë me anijen.

2. Aplikime

- Këto tarifa aplikohen për ato anije, të cilat vijnë në/ose përdorin Portin e Durrësit.
- Këto tarifa janë të detyrueshme në të gjitha anijet, përfshirë anijet e zotëruara nga qeveria shqiptare ose nga qeveria e ndonjë vendi të huaj.

3. Tarifat e kalatës/vendakostimit

- Tarifat e kalatës/vendakostimit do të llogariten bazuar në tabelën e mëposhtme.
- Tarifat e kalatës/vendakostimit, të përcaktuara nga këto tarifa janë të pagueshme menjëherë nga pronari apo agjenti i anijes, në përputhje me termat dhe kushtet e pagesës dhe mbliidhen nga Autoriteti Portual Durrës ose përfaqësuesit e tij.
- Detyrimet që lindin nga aplikimi i tarifës së kalatës/vendakostimit janë të pavarura (nuk kanë lidhje) nga detyrimet që lindin nga aplikimi i tarifave të tjera portuale.

4. Përmasat e anijes

- Nëse janë dy tonazhe bruto ose përmasa të regjistruara, në certifikatën e madhësisë së tonazhit, tonazhi ose përmasa më e madhe do të aplikohet për qëllimin e kësaj tarife.
- Në qoftë se pronari i anijes e ka të pamundur të dorëzojë një certifikatë të madhësisë së tonazhit, Autoriteti Portual i Durrësit ose përfaqësuesi i tij, mund të japë një vlerë të përafërt të tonazhit bruto ose dimensioneve të tjera që kanë të bëjnë me anijen. Tonazhi bruto ose përmasat e

tjera, të përcaktuara në këtë mënyrë, do të përdorën si tonazh bruto apo përmasat e regjistruara, për efekt të kësaj tarife.

5. Përfshirje

Tarifat e kalatës/vendakostimit nuk janë të pagueshme në lidhje me:

- a) një luftanije ose ndonjë anije nën komandën e forcave shqiptare, ose një anije e një force vizitore;
- b) një anije që i përket qeverisë shqiptare ose të një vendi të huaj dhe që nuk është e angazhuar në veprimtari tregtare;
- c) një anije e angazhuar vetëm në peshkim dhe të tjera që e tregtojnë peshkun;
- d) një anije e përjashtuar nga aplikimi i këtyre tarifave, si rezultat i ndonjë marrëveshjeje ndërmjet Shqipërisë dhe një vendi të huaj.

2.2 Tarifat e kalatës/vendakostimit

1. Tarifat e kalatës/vendakostimit për anijet, janë të llogaritura bazuar në përmasat e anijes (gjatësia ose gjerësia e përgjithshme sipas akostimit), si dhe kohës së qëndrimit:	Njësia bazë	Tarifa (€)
a) Anije kontejner	€/metër linear të anijes për ditë ose pjesë të saj	4.41
b) Cisterna (kimikate/ lëngje rinfuze)	€/metër linear të anijes për ditë pjesë të saj	3.85
c) Anije kroçere	€/metër linear të gjatësisë së anijes për ditë ose pjesë të saj	1
d) Tragete, anije Ro/Ro dhe pasagjerësh	€/metër linear të gjatësisë së anijes për ditë ose pjesë të saj	3.50
e) Anije transporti mallrash rifuxho	€/metër linear të gjatësisë së anijes për ditë ose pjesë të saj	3.80
f) Anije transporti mallrash gjenerale	€/metër linear të gjatësisë së anijes për ditë ose pjesë të saj	3.80



2. Tarifat e kalatës/vendakostimit për anijet ose mjete lundrimi shërbimi që qëndrojnë në Portin e Durrësit për një kohë të pacaktuar dhe që nuk janë të angazhuara në veprimtari tregtare. Këto tarifa llogariten bazuar në kategorinë e madhësisë së anijes në GT dhe/ose gjatësisë së përgjithshme të saj dhe kohën e qëndrimit.	Njësia bazë	Tarifa(€)
a) Për anije (ose mjete lundrimi) deri në dhe përfshirë 500 GT	€/anije/muaj	113.00
b) Për anije (ose mjete lundrimi) mbi 500 GT	€/metër linear në ditë ose pjesë të saj	1.27
c) Skafe turistike	euro / ditë	10
d) Biga	euro/metër linear në ditë	0.8

KAPITULLI 2

TARIFAT E PËRPUNIMIT TË PAGUESHME NGA PRONARI APO AGJENTI I ANIJES APO MALLIT

3. TARIFAT E PËRPUNIMIT TË ANIJEVE ME MALLRA

3.1 Përkufizime

1. Interpretime

- “Tarifë përpunimi” (*handling charges*) do të thotë një tarifë shërbimi ndaj pronarit të anijes apo mallit ose agentit të tij për ngarkim-shkarkimin e anijes në Portin e Durrësit;
- “Pronar” do të thotë agjenti, marrësi me qira (*charterer*) ose zotëruesi i anijes;
- “Port” do të thotë Porti i Durrësit i organizuar sipas ligjit të Autoritetit Portual Durrës;
- “Certifikata e tonazhit/madhësisë së mallit” do të thotë një dokument (p.sh. një manifest apo faturë e mallit, listë e mallrave) e lëshuar nga dërguesi i mallrave, pronari, marrësi me qira ose nga agjenti ose agentët e tyre, të cilët lëshojnë madhësinë e mallit në termat ton ose metër kub.
- Vetëm në rast se është specifikuar ndryshe, në këtë kapitull, termi “përpunim” përfshin ngarkimin ose shkarkimin e mallrave dhe kontejnerëve dhe imbarkimin apo dizimbarkimin e pasagjerëve.

2. Aplikime

- Këto tarifa aplikohen në lidhje me mallrat dhe pasagjerët që mbërrijnë/ikin me anije, të cilat vijnë në ose përdorin Portin e Durrësit për qëllim ngarkimi ose shkarkimi dhe ose imbarkimi apo dizimbarkimi të pasagjerëve dhe RoRo respektivisht.
- Këto tarifa janë të detyrueshme për të gjitha anijet, përfshirë anijet e zotëruara nga qeveria shqiptare ose nga qeveria e ndonjë vendi të huaj.

3. Tarifa e përpunimit (*handling charges*)

- Tarifa e përpunimit do të llogaritet siç është vendosur në tabelën e mëposhtme të tarifave.
- Tarifa e përpunimit, e përcaktuar në këtë tarifë, është e pageshme menjëherë dhe mbledhet nga Autoriteti Portual Durrës ose përfaqësuesit e tij (stevedorë ose operatorë terminali të licencuar) në përputhje me termat dhe kushtet e pagesës.
- Detyrimet që lindin nga aplikimi i tarifës së përpunimit, janë të pavarura (nuk kanë lidhje), nga detyrimet që lindin nga aplikimi i tarifave të tjera portuale.

4. Madhësia e mallrave

a) Nëse janë dy tonazhe bruto ose përmasa të regjistruara të ndryshme, p.sh., ton dhe m³ në certifikatën e madhësisë së tonazhit, tonazhi ose përmasa më e madhe (p.sh. 3 tonë dhe 8 m³) do të aplikohet për qëllimin e kësaj tarife.

b) Në qoftë se pronari ose agjenti i anijes e ka të pamundur të dorëzojë një certifikatë të madhësisë/përmasave të mallit (p.sh. manifest, faturë apo listë mallrash), Autoriteti Portual i Durrësit ose përfaqësuesi i tij mund të japë një vlerë të përafërt të madhësisë dhe peshës apo volumit të mallit, që do të konsiderohen përmasat e mallit në ton apo metër kub për qëllim të tarifave.

5. Përrjashtime

1. Kostot e përpunimit nuk janë të pagueshme në lidhje me:

a) një luftanije ose ndonjë anije nën komandën e forcave shqiptare, ose një anije e një force vizitore;

b) një anije që i përket qeverisë shqiptare ose të një vendi të huaj dhe që nuk është e angazhuar në veprimtari tregtare;

c) një anije e përjashtuar nga pagesa e të tilla tarifave si rezultat i ndonjë marrëveshje ndërmjet Shqipërisë dhe një vendi të huaj.

3.2 Përkufizime mbi përpunimin e mallrave rifuxho

1. Këto detyrime janë të vendosura nga Autoriteti Portual dhe/ose Stivadori i licencuar përkundrejt pronarit ose agjentit të anijes dhe/ose mallit, për ngarkimin ose shkarkimin e anijes.

2. Shërbimet e përfshira në tarifë në rast të shkarkimit të anijes

i) Shkarkimi nën drejtimin/orientimin e komandës së anijes nga pika e qëndrimit në anije deri në kalatë ose në automjet.

ii) Lëvizja e mallrave nga vendi i shkarkimit për në magazinë ose në sheshin e hapur brenda së njëjtës zonë të terminalit në afërsi të kalatës.

iii) Vendosja e mallrave nga magazina ose sheshi i hapur në automjetin e dorëzimit.

3. Shërbimet e përfshira në tarifë në rast ngarkimi të anijes:

i) shkarkimi në port i mallrave nga automjeti i dërguesit dhe vendosja e mallit në pikën e depozitimit në magazinë ose në sheshe të hapura;

ii) lëvizja e mallrave brenda së njëjtës zonë (hapësirë të të njëjtit terminal) në port nga pika e depozitimit në magazinë ose në sheshe të hapura përgjatë kalatës së anijes;

iii) ngarkim nën drejtimin/orientimin e komandës së anijes së mallrave për anijen brenda hambarit ose mbi kuvertën e anijes përfshirë dhe pozicionimin profesional të mallrave në hambar/kuvertë;

iv) shkarkimi në port i mallrave nga automjeti i dërguesit dhe ngarkimi i mallrave në të njëjtën zonë/kalatë në port nën drejtimin/orientimin e komandës së anijes së mallrave për anijen brenda hambarit ose mbi kuvertën e anijes, përfshirë dhe pozicionimin profesional të mallrave në hambar/kuvertë;

4. Shërbimet nën këto përkufizime nuk përfshijnë:

i) sistemimin (*trimming*) në hambarin e anijes së mallrave rifuxho;

ii) hapjen dhe mbylljen e kapakut të hambarit;

iii) manipulimin e pajisjeve të anijes;

iv) numërimin e mallit;

v) furnizimi i pajisjeve ose i ndonjë materiali të ngjashëm për sigurimin e mallit;

vi) furnizimin me material dhe konstruktimin në hambarin e anijes me qëllim të ndarjes së mallrave;

vii) lëvizja e mallrave ndërmjet zonave të ndryshme të portit (përrjashtohet zona e dy kalatave fqinje);

të cilat të gjitha ose në veçanti mund të jenë shërbime për të cilat do të aplikohen pagesa më vetë.



3.3 Tarifat për përpunimin e mallrave të rënda rifuxho

Njësia	Artikulli	Njësia bazë	Çmimi (lekë)
1.	Qymyr	lekë/tonë	480
2.	Minerale, koncentrate dhe ferrot e tyre (krom, hekur nikel, bakër, pirit, silic etj.)	lekë/tonë	654
3.	Materiale ndërtimi (klinker, materiale inerte, zhavorr, rërë, gurë, gëlqere, rërë xhami, dolomitë, barite etj.)	lekë/tonë	558
4.	Çimento rinfuze me pompë vakuumi	lekë/tonë	526
4/1	Çimento rifuzo me pompë vakuumi, për eksportin e volumeve të mëdha të përpunimit mbi 200 000 tonë në vit. Kjo tarifë aplikohet, mbi të gjithë sasinë e eksportuar për periudhën 1.1.2013 deri 31.12.2013	lekë/ton	424
5.	Skrap	lekë/tonë	633
6.	Tarifa për sigurinë	lekë/tonë	14
7.	Mallra të rrezikshme (sipas IMO/IMDG code)	lekë/tonë	shtesë 100% mbi tarifën standarde

3.4 Tarifat për përpunimin e mallrave të lehta rifuxho

Njësia	Artikulli	Njësia bazë	Çmimi (lekë)
1.	Squfur	lekë/tonë	637
2.	Grurë, drithëra, ushqim për kafshët	lekë/tonë	682
3.	Plehra kimike	lekë/tonë	575
4.	Ngarkesa të rrezikshme (sipas kodit IMO/IMDG)	lekë/tonë	shtesë 100% mbi tarifën standarde
5.	Tarifë për sigurinë	lekë/tonë	14

3.5 Tarifat për përpunimin e mallrave të lëngshme

Njësia	Artikulli	Njësia bazë	Çmimi (lekë)
1.	Ngarkim-shkarkim të mallrave të lëngshme në kalatë (verë, vaj ushqimor etj.)	lekë/tonë	280
2.	Shkarkimi i produkteve të lëngshme në pontil	lekë/tonë	210
3.	Shkarkimi i benzinë, benzol, vajguri (avionësh) në kalatë	lekë/tonë	560

4.	Karburant, mazout, bitum në kalatë	lekë/tonë	280
5.	Tarifa e sigurisë	lekë/tonë	14
6.	Ngarkesa të rrezikshme (sipas kodit IMO/IMDG)	lekë/tonë	shtesë 100% mbi tarifën standarde

3.6 Përkufizime mbi përpunimin e mallrave gjenerale

1. Këto detyrime janë të vendosura nga Autoriteti Portual dhe/ose Stivadori përkundrejt pronarit ose agjentit të anijes dhe ose mallit për ngarkimin ose shkarkimin në/nga anija.

2. Shërbimet e përfshira në tarifë, në rast të shkarkimit të anijes:

i) Shkarkim nën drejtimin/orientimin e komandës së anijes nga pika e qëndrimit në anije deri në kalatë ose në automjet;

ii) Lëvizja e mallrave nga pika e shkarkimit për në magazinë ose në sheshin e hapur brenda së njëjtës zonë të terminalit në afërsi të së njëjtës kalatë.

iii) Vendosja e mallrave nga magazina ose sheshi i hapur në automjetin e dorëzimit.

3. Shërbimet e përfshira në tarifë në rast të ngarkimit të anijes

i) Shkarkimi në port i mallrave nga automjeti i dërguesit dhe vendosja e mallit në pikën e depozitimit në magazinë ose në sheshe të hapura.

ii) Lëvizja e mallrave brenda së njëjtës zonë (hapësirë të të njëjtit terminal dhe kalatë) në port nga pika e depozitimit (magazinë ose në sheshe të hapura) përgjatë anijes.

iii) Ngarkim nën drejtimin/orientimin e komandës së anijes të mallrave për anijen brenda hambarit ose mbi kuvertën e anijes përfshirë dhe pozicionimin profesional të mallrave në hambar/kuvertë.

iv) Shkarkim në port i mallrave nga automjeti i dërguesit dhe ngarkim i mallrave brenda së njëjtës zonë në port nën drejtimin e komandës së anijes të mallrave për anijen brenda hambarit ose mbi kuvertën e anijes përfshirë dhe pozicionimin profesional të mallrave në hambar/kuvertë.

4. Shërbimet nën këto përkufizime nuk përfshijnë:

i) lidhjen dhe zgjidhjen (*lashing and unlashing*) e mallrave ose kontejnerëve;

ii) hapje mbyllje të hambarit;

iii) manipulimin e pajisjeve të anijes (*rigging of ship's gear*);

iv) numërimin e mallit ose kontejnerëve;

v) furnizimi i pajisjeve ose i ndonjë materiali të ngjashëm për sigurimin e mallit;

vi) lëvizje ekstra (*shifting*) e mallrave ose kontejnerëve në hambarë të anijes, ose në anije ose në kalatë përgjatë kalatës ose në magazine apo sheshe;

vii) rikuperimi i paketimit të mallrave të dëmtuara ;

viii) mbledhja e mallrave të derdhura ose të shpërndara në vendet e mbledhjes ose ndonjë aktivitet i ngjashëm;

ix) lëvizja apo paraqitja e mallrave në përmbushje të kërkesës së doganës për kontroll doganor;

x) çdo aktivitet tjetër që nuk është përshkruar në 2 ose 3;

të cilat të gjitha ose në veçanti mund të jenë shërbime që do të paguhen me vete.



3.7 Tarifat për përpunimin e mallrave gjenerale

Nr.	Artikulli	Njësia bazë	Çmimi (lekë)
1.	(Normal) mallra gjenerale, si: fuçi, ballo, binare, rrumbuj, koli çeliku, hekur, llamarinë, tuba, pllaka zdrukthi, pako, arka të ndryshme etj., deri dhe përfshirë 1500 kg/njësi	lekë/tonë	556
2.	(Të rënda) ngarkesa të rënda fuçi, ballo, binare, rrumbuj, koli çeliku, hekur, llamarine, tuba, pllaka zdrukthi, pako, arka të ndryshme etj., mbi 1500 kg/njësi	lekë/tonë	482
3.	(Shumë të rënda) ngarkesa të rënda dhe me përmasa të mëdha (makineri, pajisje, etj.) mbi 5000 kg/njësi	lekë/tonë	subjekt negociimi mbi tarifën
4.	(Të lehta) box, të ndryshme, ngarkesa të lehta dhe gabarite (ambalazhe, goma, depozita uji dhe mallra mbi 3 m ³)	lekë/tonë	1,155
5.	Ngarkesa me thasë	lekë/tonë	650
6.	Ngarkesa të paletizuara apo prepaketuara (<i>big bags, slinga</i> etj.)	lekë/tonë	620
6/1.	Çimento me slinga, për stimulimin e volumeve të mëdha të eksportit mbi 150 000 tonë në vit. Kjo tarifë aplikohet mbi të gjithë sasinë e eksportuar për periudhën 1.1.2013 deri 31.12.2013	lekë/tonë	570
7.	Ngarkesa që prishen (paleta, pako, thasë, si p.sh.: fruta të freskëta, banane, zrazavate, mish i ngrirë, vezë etj.)	lekë/tonë	shtesë 25 % mbi tarifën standard
8.	Bllloqe mermeri (çfarëdo madhësie)	lekë/tonë	482
9.	Ngarkesa të rrezikshme (eksplozivë, lëndë djegëse sipas kodit IMDG)	lekë/tonë	shtesë 100% mbi tarifën standard
10.	Tarifë për sigurinë	lekë/tonë	19

3.8 Përkufizime të tjera për imbarkimin/dizimbarkimin e pasagjerëve

1. Këto tarifa paguhen nga zotëruesi i anijes ose agjenti i tij, për imbarkimin dhe dizimbarkimin e pasagjerëve në/nga anija dhe mblidhen nga Autoriteti Portual Durrës ose përfaqësuesi i tij i autorizuar.

2. Shërbimet e përfshira në këtë tarifë janë:

i) Sigurimi i faciliteteve të pasagjerëve dhe shërbimet lidhur me to në Portin e Durrësit, duke lejuar hyrje dhe dalje të sigurt në/nga anijet e ankoruara në kalatë;

ii) Ofrimi i sigurisë, faciliteteve dhe shërbimeve të sigurta në Portin e Durrësit;

- iii) Strehimi dhe facilitetet/objektet e duhura sanitare;
- iv) Përpunimi i dokumentacionit përkatës.

3. Shërbimet sipas këtyre përkufizimeve nuk përfshijnë:

i) çdo shërbim tjetër që nuk është përmendur në pikën 2, i cili mund të jetë shërbim që faturohet dhe paguhet me vete.

4. Për qëllim të kësaj tarife, të rriturit janë persona 12 vjeç e sipër. Me kërkesë të Autoritetit Portual Durrës ose përfaqësuesit të tij të autorizuar, pasagjerët duhet të paraqesin dokumentin e tyre të identitetit (p.sh. pasaportën ose kartën e identitetit) për të lejuar kështu Autoritetin Portual ose përfaqësuesin e tij të autorizuar të verifikojë moshën e tyre.

3.9 Tarifat e imbarkimit/dizimbarkimit të pasagjerëve me tragete

Njësia	Artikulli	Njësia bazë	Detyrimi (€)
1.	Tarifë fikse për çdo mbërritje të tragetit		11.58
2.	Imbarkimi i pasagjerëve		
	a) Pasagjerë nën 12 vjeç	person	2
	b) Pasagjerë mbi 12 vjeç	person	4
	c) Tarifa e sigurisë për pasagjerë (vetëm për të rritur)	person	0.5
3.	Dizimbarkimi i pasagjerëve		
	a) Pasagjerë nën 12 vjeç	person	0
	b) Pasagjerë mbi 12 vjeç	person	0.5
	c) Tarifa e sigurisë për pasagjerë (vetëm për të rritur)	person	0.5

3.10 Përkufizime të tjera për përpunimin Roll-on/Roll-off të ngarkesave

1. Këto detyrime janë vendosur nga Autoriteti Portual ose Stivadori ndaj zotëruesit ose agentit të anijes dhe/ose mallit për ngarkimin ose shkarkimin Roll-on/Roll-off të mallrave në/nga anijet, tragetet e pasagjerëve, mbajtësit e makinave ose të anijeve të ngjashme.

2. Në rast të shkarkimit të anijes, në tarifën e shërbimit përfshihet:

i) Lëvizja e ngarkesës nën drejtimin e komandës së anijes nga kuverta e anijes deri në vendin e qëndrimit, në terminalin e portit.

ii) Dorëzimi i ngarkesës, nga vendi i qëndrimit në terminalin e portit, pronarit të ligjshëm ose përfaqësuesit.

3. Në rast të ngarkimit të anijes, në tarifën e shërbimit përfshin:

i) Marrjen e ngarkesës nga transportuesi dhe lëvizjen e saj në drejtim të pikës së qëndrimit në terminalin e portit.

ii) Lëvizjen e ngarkesës nga vendi i qëndrimit në rampat e anijes dhe lëvizjet e mëtejshme nën drejtimin e komandës së anijes në hambarin ose kuvertën e anijes.

4. Këto shërbime nuk përfshijnë:

i) lidhjen, zgjidhjen dhe sigurimin e ngarkesës në anije;

ii) lidhjen, zgjidhjen dhe sigurimin e ngarkesës në trailer, mjet apo shasi, e cila është përgjegjësi e pronarit të mjetit.



iii) rimorkimin dhe/ose lëvizjen e makinave me mjete dhe/ose nëse janë apo jo vetështytëse nga personeli i portit dhe/ose Stivadori, në terminalin e portit ose/dhe në hambarin ose në kuvertën e anijes, kur ato nuk kanë lidhje direkt me procesin e ngarkim-shkarkimit.

iv) ndihma për ndezjen e motorit;

v) spontimi ose aktivitete të ngjashme.

5. Në lidhje me këto tarifa termi “automjet” përfshin kamion, gjysmërimorkiator, gjysmërimorkio, rimorkio, automjete për transport të veçantë, automjete për përdorim të veçantë, automjete bujqësore, automjete teknologjike industriale, kokë tërheqëse/trailer, mikrobus ose sisteme automjet/karavan, kampera.

6. Nëse nuk është shprehur ndryshe, termi “automjet” përfshin dhe autoveturat.

3.11 Tarifat e përpunimit të automjeteve¹ dhe makinave (mallra Ro/Ro)

1.	Ngarkimi i automjeteve	Njësia bazë	Detyrimi (€)
a)	Automjet deri në dhe përfshirë 3,5 tonë	automjet	6
b)	Automjete mbi 3,5 deri në dhe përfshirë 7,5 tonë	automjet	10
c)	Automjete mbi 7,5 tonë	automjet	13
2.	Shkarkimi i automjeteve	njësia bazë	detyrimi (€)
a)	Automjet deri në dhe përfshirë 3,5 tonë	automjet	2
b)	Automjete mbi 3,5 deri në dhe përfshirë 7,5 tonë	automjet	3
c)	Automjete mbi 7,5 tonë	automjet	4
3.	Shërbime për ngarkimin ose shkarkimin e mjeteve apo ngarkesave	njësia bazë	detyrimi (€)
a)	Rimorkimin e ngarkesës Ro/Ro me kokat tërheqëse, në dy mënyrat, p.sh. ngarkim ose shkarkim	për njësi	20
b)	Shërbimi i drejtimit të mjetit ²	automjet	2
1)	Automjet deri në dhe përfshirë 3,5 tonë	automjet	4
2)	Automjete mbi 3,5 deri në dhe përfshirë 7,5 tonë	automjet	6
3)	Automjete mbi 7,5 tonë	automjet	10
b)	Dhënia me qira e lefterakut të portit në terminalin e trageteve për përpunimin e mallrave në bord të anijes	njësi/orë	24

¹

² Për rastet kur mjetet imbarkohen apo dizimbarkohen, duke u drejtuar nga punonjësit e autorizuar të Terminalit të Trageteve.

- | | | | |
|----|---|-----------|---|
| c) | Pagesa e një tarife sigurie për automjete deri dhe përfshirë 3.5 tonë, në të dyja mënyrat; p.sh. ngarkim ose shkarkim | për njësi | 1 |
| d) | Pagesa e një tarife sigurie për automjete mbi 3.5 tonë, në të dyja mënyrat p.sh. ngarkimin ose shkarkimin | për njësi | 2 |

3.12 Përkufizime të tjera për përpunimin e kontejnerëve

1. Këto detyrime janë vendosur nga Autoriteti Portual, Stivadori i licencuar ose operatori i Terminalit, ndaj pronarëve ose agentit të anijes dhe ose mallit për ngarkimin ose shkarkimin e kontejnerëve (ose *flat racks*) në/prej anijeve.

2. Në rastin e shkarkimit të anijeve, tarifat e shërbimit përfshijnë:

i) Shkarkimin e kontejnerit nën drejtimin e komandës së anijes nga hambari ose kuverta e anijes, në pikën e shkarkimit në kalatën e portit.

ii) Lëvizja e kontejnerit nga pika e shkarkimit për në vendin (slotin) e caktuar në sheshin e portit (terminalit të kalatës së anijes).

iii) Dërgimi (ngarkimi) i kontejnerit nga pika e shkarkimit në zonën (slotin) e caktuar të sheshit të portit (terminalit), për në kamionin e marrësit të ngarkesës.

3. Në rastin e ngarkimit të anijes, tarifa e shërbimit përfshin:

i) Marrjen e kontejnerit nga automjeti i dërguesit, në zonën e marrjes së terminalit dhe lëvizjen e tij në slotin e caktuar të terminalit.

ii) Lëvizja e kontejnerit nga pika e depozitimit (në slotin e caktuar në terminalin e portit) për në pikën e ngarkimit përgjatë anijes.

iii) Ngarkimi i kontejnerit në kuvertën e anijes, nën drejtimin e komandës së anijes, në hambarin ose kuvertën e anijes në përputhje, me planin e komandës së anijes për stivimin e ngarkesës.

4. Këto shërbime në 2 dhe 3 përfshijnë:

i) Kontrollin dhe regjistrimin e numrit dhe të vulës së kontejnerit;

ii) Lërimin ose mbërthimin e përshtatësve para ose pas përpunimit për procesin e ngarkim-shkarkimit (ship-to-shore handling);

iii) Përgatitjen e *an Equipment Interchange Receipt (EIR)*³;

iv) Regjistrimin e pozicionit të kontejnerit në shesh.

5. Këto shërbime në 2 dhe 3 nuk përfshijnë:

i) Lidhjen dhe zgjidhjen e kontejnerit në anije “Lashing and unlashing of containers on the vessel”;

ii) Heqjen dhe vendosjen e “teist lock”;

iii) Peshimin e kontejnerëve;

iv) Ndonjë aktivitet në lidhje me kërkesat e doganës për inspektim;

v) Leximin, regjistrimin dhe kontrollimin e temperaturës;

vi) Furnizimi me energji elektrike (heqja dhe vendosja e prizës) e kontejnerëve frigoriferikë;

vii) Mbushja dhe zbrazja e kontejnerëve.

Këto shërbime të gjitha ose në veçanti do të faturohet dhe do të paguhet më vete.

³ Një dokument për transferimin e kontejnerit nga një mbajtës në një tjetër, ose në prej terminalit.



3.13 Tarifat për përpunimin e kontejnerëve

Njësia	Artikulli	Njësia bazë	Detyrimi (lekë)
1.	Ngarkimi dhe shkarkimi i kontejnerëve apo flat racks ⁴ plot		
a)	Shkarkimi (20 feet)	lekë/box	9,692
b)	Shkarkimi 40 feet, 45 feet)	lekë/box	11,720
c)	Ngarkimi (20 feet)	lekë/box	9,472
d)	Ngarkimi (40 feet, 45 feet)	lekë/box	10,813
2.	Ngarkimi dhe shkarkimi i kontejnerëve bosh		
a)	Shkarkimi (20 feet)	lekë/box	6,012
b)	Shkarkimi 40 feet, 45 feet)	lekë/box	7,305
c)	Ngarkimi (20 feet)	lekë/box	5,762
d)	Ngarkimi (40 feet, 45 feet)	lekë/box	6,826
3.	Shërbime ekstra për përpunimin e kontejnerëve		
a)	Përkufizime shtesë për shërbime ekstra në përpunimin e kontejnerëve		
i)	Tarifa për shërbimet shtesë mbliidhen nga Autoriteti Portual, Operatori i licencuar apo Operatori i Terminalit, nga zotëruesi i anijes apo i kontejnerit apo i mallit ose agjenti i tij, cilido që të jetë rasti.		
ii)	Për të mënjeluar çdo dyshim, detyrimi për të paguar tarifën ekstra të cilat përfshihen në pikën 3.12 pika 3 dhe 4, janë në përgjegjësi të subjektit përfaqësues, i cili ka kërkuar kryerjen e këtyre shërbimeve tek Autoriteti Portual, Operatori i Licencuar ose Operatori i Terminalit, në formë të shkruar.		
b)	Përpunimi ekstra i kontejnerëve bosh në sheshin e të njëjtit terminal	lekë/box/ kapje	1.307
c)	Përpunimi ekstra i kontejnerëve plot në sheshin e të njëjtit terminal	lekë/box/ kapje	2.035
d)	Përpunimi ekstra i ndonjë kontejneri për qëllim peshimi (të gjitha madhësitë) (Shënim. Deklarimi i gabuar për peshën e kontejnerit është shkelje ligjore dhe mund të kërkojë dëmshpërblimin përkatës.)	lekë/box/ kapje	854
4.	Të tjera, shërbime ndihmëse në lidhje me kontejnerët		
a)	Furnizim me energji për kontejnerët me temperaturë të kontrolluar	lekë/box/ditë	1,122
b)	Pastrim i kontejnerëve (brenda, gjithëpërfshirës me fshesë)		

⁴ Flat racks consist of a floor structure with a high loading capacity composed of a steel frame and a softwood floor and two end walls, which may either be fixed or collapsible.

i)	Deri në dhe përfshirë 20 feet në gjatësi	lekë/box	1,220
ii)	Gjatësia mbi 20 feet	lekë/box	2,440
c)	Lidhja dhe zgjidhja e kontejnerëve në anije për operacion (lashing and unlashing) materialet lidhëse, zgjidhëse duhet të sigurohen nga zotëruesi i anijes	lekë/box	403
d)	Ristivime spostime	lekë/box	3,972
e)	Hapje dhe mbyllje e kapakut të hambarit (cikli i plotë)	lekë/hambar	10,763
f)	Tarifa fikse totale për kamionët e kontejnerëve (çdo madhësi) që hyn ose del nga Porti i Durrësit	lekë/kamion	250
g)	Tarifa për sigurinë portuale bazuar në kërkesat e ISPS-së.		
i)	deri dhe përfshirë 20'	lekë/box	244
ii)	Mbi dhe përfshirë 40'	lekë/box	488
5.	Peshimi i detyrueshëm		
a)	Autoriteti Portual ose Stivadori rezervon të drejtën e pakufizuar të peshojë çdo kontejner për llogari të anijes, transportuesit ose marrësi i ngarkesës, ose të agjentit me shpenzime të tyre, nëse pesha e kontejnerit nuk është qartësisht e identifikuar.	lekë/box	e negociue shme
b)	Për të shmangur dyshimet, deklarimi i gabuar apo mosdeklarimi i mallrave të rrezikshme (sipas kodit IMDG), që transportohen në kontejner dhe etiketa korresponduese e kontejnerit ose deklarimi i gabuar apo mosdeklarimi i peshës së kontejnerit është një shkelje e ligjit dhe sjell një dënim të rëndë në përputhje me dëmet.		
	3.14 Tarifa për raste të veçanta		
1.	Tarifa për rastet e përpunimit me mjetet e zotëruesit të mallit apo anijes (ose përfaqësuesit e tyre)	50% e tarifës së aplikueshme	
	Për raste të veçanta kur Autoriteti Portual Durrës dhe Operatori i autorizuar janë në rrethana që nuk disponojnë apo nuk mund të sigurojnë mjetet që garantojnë përpunimin e anijes (<i>ship to shore equipment</i>), mbështetur në kërkesën e përdoruesit, Autoriteti Portual Durrës mund të lejojë përpunimin e anijes me mjetet e veta. Tarifa e përpunimit në këto raste do të aplikohet në masën 50% të tarifës së plotë.		
2.	Tarifa për ditët e diela dhe festa zyrtare	10% shtesë e tarifës përkatëse	
3.	Përpunohen pa shtesë tarife anijet, si më poshtë:		



- i) tragete, RoRo që përpunohen me mjetet e veta
 - ii) anijet e karburanteve
 - iii) anije që transportojnë kafshë të gjalla ose mallra që prishen shpejt
4. Tarifa për mallrat në hambar bunker 100% shtesë e tarifës përkatëse
5. Tarifa për lëvizjen e mallrave transit në hambar apo kuvertë 50% shtesë e tarifës përkatëse
6. Përrjashtime në rastet “double banking”
- a) Për rastet e ngarkim-shkarkimit të anijeve me tonazh të madh, ku procesi nuk mund të kryhet i plotë në kalatat e Portit dhe do të realizohet nëpërmjet operacioneve “double banking” në radën e Portit të Durrësit.
 - ii) Nuk do të aplikohet shtesa e tarifës për punën në ditët e diela dhe festat.

KAPITULLI 3

TARIFAT E SHESHIT PRANË KALATËS DHE TË TRANSFERIMIT TË PAGUESHME NGA PRITËSI I MALLIT OSE SPEDICIONI

4. TARIFA WHARFAGE DHE TRANSFERIMIT

4.1 Përkufizime

1. Interpretime

- a) “Fasilitetet publike të portit” do të thotë një kalatë, shesh, sheshe pranë kalatës, mol, dallgëthyes, terminal, magazinë ose ndonjë ndërtesë tjetër;
- b) “Tarifë transferimi” do të thotë një tarifë në lidhje me transferimin e mallrave nga një anije në një tjetër brenda limiteve të portit;
- c) “Port” do të thotë Porti i Durrësit i projektuar sipas ligjit të Autoritetit Portual Durrës;
- d) “Wharfage” do të thotë një detyrim i përfutur në përputhje me këtë tarifë në lidhje me të gjitha mallrat, të cilat janë:
 - i) ngarkuar ose shkarkuar nga një anije në një fasilitet publik të portit;
 - ii) shkarkuar nga anija në kalatë (*wharf*) ose e ngarkuar nga kalata në anije, e depozituar nga një vend në kalatë ose e ngarkuar apo shkarkuar nga një automjet në hapësirën publike të portit.
- e) “Wharf” do të thotë çdo kalatë, vend depozitimi pranë kalatës, e cila është fasilitet publik i portit.

2. Aplikime

- a) Kjo tarifë aplikohet në lidhje me të gjitha anijet dhe me mallrat e transportuara nga këto anije, duke përfshirë anijet e poseduara nga qeveria shqiptare ose nga qeveria e një vendi të huaj.

3. Detyrimet e përgjithshme

- a) Detyrimet *wharfage* dhe të transferimit, të përcaktuara nga këto tarifa, janë të pagueshme menjëherë dhe do të mblidhen nga Autoriteti Portual Durrës ose përfaqësuesit e tij të autorizuar, nga spedicionerët ose pritësi i mallit ose agjenti i tyre në përputhje me termat dhe kushtet e pagesës.
- b) Detyrimet që lindin nga aplikimi i tarifës së *wharfage* janë të pavarura nga detyrimet që lindin nga aplikimi i tarifave të tjera portuale.

5. Dokumentacioni

a) Dokumentacioni i plotë, përfshirë *bills of lading*, në lidhje me mallrat hyrëse dhe dalëse dhe/ose mallrave në kontejnerë ose trailera apo shasi të një anije, do të sigurohen nga një person në detyrë i anijes për Autoritetin Portual ose përfaqësuesit të tij, kur t'i kërkohet.

b) Autoriteti Portual i Durrësit ose përfaqësuesi i tij, rezervon të drejtën të klasifikojë mallrat dhe vendimi i tij në lidhje me këtë do të jetë përfundimtar dhe i detyrueshëm.

6. Tarifa e *wharfage*

a) Tarifa *wharfage* e pagueshme do të llogaritet bazuar në tabelën e mëposhtme të tarifave.

b) Tarifa *wharfage* nuk është e pagueshme në lidhje.

i) një luftanije ose ndonjë anije nën komandën e forcave shqiptare, ose një anije e një force vizitore;

ii) shkarkim i peshkut nga anije peshkimi ose furnizime të ngarkuara në një anije peshkimi akostuar në një fasilitet publik të portit;

iii) ndonjë mjet motorik kur automjeti është imbarkuar ose dizimbarkuar nga një traget;

iv) mallrat e mbartura nga ndonjë anije, e cila është e përjashtuar nga tarifa *wharfage* në bazë të termave të një marrëveshjeje ndërmjet Shqipërisë dhe ndonjë vendi të huaj.

7. Tarifat e transferimit

a) Tarifat e pagueshme të transferimit do të kalkuloohen në masën 1/4 të tarifës *wharfage*. Transfer do të nënkuptojë shkarkimin (ardhjen) e një malli nga një anije, qëndrimin në port (terminal) dhe ngarkimin (largimin) nga porti (terminali) të këtij malli në anije.

b) Tarifat e transferimit nuk janë të pagueshme në lidhje me:

i) Një luftanije ose ndonjë anije nën komandën e forcave shqiptare ose një anije e një force vizitore;

ii) një anije që i përket qeverisë së një vendi të huaj dhe që nuk është e angazhuar në veprimtari tregtare;

iii) një anije e angazhuar vetëm në peshkim dhe të tjera që e tregtojnë peshkun;

iv) një anije ose mjet lundrues që përdoret për qëllime argëtimi/pushimi, e cila nuk është e angazhuar në veprimtari tregtare;

v) një anije e përjashtuar nga pagesa e të tilla tarifave, si rezultat ndonjë marrëveshjeje ndërmjet Shqipërisë dhe një vendi të huaj.

4.2 Tarifat *wharfage*

1. Tarifa <i>wharfage</i>	Njësia bazë	Tarifa (lekë)
a) Tarifa <i>wharfage</i>	lekë/tonë	24

4.3 Tarifat e transferimit

1. Tarifa e transferimit	Njësia bazë	Tarifa
a) Tarifa e transferimit	lekë/tonë	¼ një e katërta e tarifës së <i>wharfage</i>

KAPITULLI 4 MAGAZINIM, QIRAJA DHE TARIFAT E QIRADHËNIES

5. TARIFAT E MAGAZINIMIT TË NGARKESAVE DHE KONTEJNERËVE

5.1 Përkufizime

1. Interpretimi

Në këtë tarifë:

a) “Ditë” nënkupton një periudhë prej 24-orësh konsektive;



b) “Fasilitet portual” nënkupton *wharf*, kalatë, valëpritësin, terminalin, magazinë shesh ose ndërtesa të tjera në port;

c) “Magazinim, depozitim” do të thotë një detyrim financiar i pagueshëm për mallrat që qëndrojnë në fasilitetet portuale në Portin e Durrësit;

d) “Shesh depozitimi” sheshe të destinuar për depozitimin e mallrave të ndryshme;

e) “Shesh në përdorim” sheshe të destinuar për depozitimin e mallrave të ndryshme për përdorim të përkohshëm jo më shumë se 180 ditë;

f) “Shesh tranzit” sheshe të destinuar për realizimin e proceseve të ngarkim-shkarkimit me afat jo më shumë se 25 ditë.

2. Aplikimi

a) Pagesat e magazinimit që llogariten në përputhje me këtë tarifë, paguhen për ato mallra që qëndrojnë në Portin e Durrësit dhe në fasilitetet e tij.

b) Kjo tarifë aplikohet për të gjitha mallrat që transportohen me anije, përfshirë anijet shqiptare ose të huaja.

3. Pagesat

a) Pagesat e magazinimit duhet të llogariten mbi bazat e tarifave të përcaktuara më poshtë:

b) Pagesat e magazinimit, të përshkruara në këtë tarifë, janë të detyrueshme për pronarin e mallit apo të kontejnerëve ose përfaqësuesi i tyre sipas termave dhe kushteve të pagesës, dhe do të mblihdhen nga Autortieti Portual Durrës ose përfaqësuesi i tij i autorizuar.

c) Pagesat e magazinimit, të përshkruara në këtë tarifë, janë shtesë të pagesave të tjera të përshkruara në tarifën e tjera.

4. Matja e zonës së magazinimit

a) Autoriteti Portual Durrës dhe/ose përfaqësuesit e tij, rezervojnë të drejtën për të vlerësuar zonën e përdorur për magazinimin e mallrave dhe kjo përllogaritje do të përdoret për përcaktimin e tarifës.

5. Përjashtime

Tarifat për magazinim nuk paguhen për:

a) Shërbimet e lidhura për një luftanije shqiptare nën Komandën e Forcave të Armatosura shqiptare, një anije e një force vizituese ose çdo anije tjetër, e cila është nën komandën e qeverisë shqiptare;

b) Mallrat e sjella nga një anije, e cila është e përjashtuar nga tarifën sipas marrëveshjes që mund të ekzistojë mes Shqipërisë dhe një vendi të huaj;

c) Kontejnerët: 10 ditët e para në të cilat kontejnerët qëndrojnë në Terminal apo në fasilitetet e Portit, me përjashtim të rasteve kur ka një marrëveshje paraprake për ruajtjen e këtyre mallrave

d) Mallra: 5 ditët e para konsektive në të cilat mallrat qëndrojnë në terminalin e fasilitetet portuale apo kalatë, me përjashtim të rasteve kur ka një marrëveshje paraprake për ruajtjen e këtyre mallrave, ose

e) Një fasilitet portual për të cilin aplikohet një tarifë e veçantë nga Autoriteti Portual.

5.2 Tarifat për magazinimin e kontejnerëve

1.	Magazinimi i kontejnerëve (bosh ose plot hyrje ose dalje)	Njësia bazë	Tarifa (lekë)
a)	deri në 10 ditë qëndrimi	lekë/TEU/ditë	free/0
b)	nga dita e 11-të deri në ditën e 15-të	lekë/TEU/ditë	343
c)	nga ditë e 16-të deri në ditën e 20-të	lekë/TEU/ditë	514
d)	mbi ditën e 20-të	lekë/TEU/ditë	684

5.3 Tarifat për magazinimin e ngarkesave

1.	Tarifa për përdorimin e magazinës	Njësia bazë	Tarifa (lekë)
a)	deri në 5 ditë	lekë/m ² /ditë	free/0
b)	6-10 ditë	lekë/m ² /ditë	20
c)	11-20 ditë	lekë/m ² /ditë	40 % shitesë/ditë
d)	21-45 ditë	lekë/m ² /ditë	60 % shitesë/ditë
e)	mbi 45 ditë	Kontrata afatgjata	

6. TARIFAT E DHËNIES ME QIRA

6.1 Tarifat për dhënien me qira të shesheve

1.	Sheshet e përdorimit për mallra rifuxho për një periudhë maksimale deri 180 ditë	Njësia bazë	Tarifa (lekë)
a)	deri 45 ditë	lekë/m ² /ditë	2
b)	46 - 60 ditë	lekë/m ² /ditë	4
c)	61 - 120 ditë	lekë/m ² /ditë	6
d)	121 - 180 ditë	lekë/m ² /ditë	10

Pas kalimit të këtij afati Autoriteti Portual Durrës do të ndjeke hapat respektivë.

2	Sheshet e përdorimit për mallra gjenerale për një periudhë maksimale deri 180 ditë	Njësia bazë	Tarifa (lekë)
a)	deri 45 ditë	lekë/m ² /ditë	4
b)	46 - 60 ditë	lekë/m ² /ditë	8
c)	61 -120 ditë	lekë/m ² /ditë	12
d)	121 -180 ditë	lekë/m ² /ditë	20

Pas kalimit të këtij afati Autoriteti Portual Durrës do të ndjeke hapat respektivë.

6.2 Tarifat për dhënien me qira të shesheve tranzitore

1	Sheshet tranzit për një periudhë maksimale deri 25 ditë	Njësia bazë	Tarifa (lekë)
---	---	-------------	---------------

Përkufizim: termi dhënie me qira e sheshit tranzitor do të thotë dhënie e sheshit pranë kalatës për periudhën tranzitore në të cilën mallrat do të ngarkohen apo do të shkarkohen

a)	deri 10 ditë	lekë/m ² /ditë	free
b)	11-15 ditë	lekë/m ² /ditë	7



c) 16-25 ditë lekë/m²/ditë 21

Pas kalimit të këtij afati Autoriteti Portual Durrës do të ndjeke hapat respektivë.

6.3 Tarifat përdorimin të silosave

1	Tarifa për silosat e grurit	Njësia bazë	Tarifa (lekë)
a)	deri 48 orë	lekë/silo/ditë	free
b)	3 - 7 ditë	lekë/silo/ditë	8.000
c)	pas kalimit të ditës së shtatë	lekë/silo/ditë	61.000

6.4 Tarifat e dhënies me qira afatgjatë të shesheve

1	Sheshe të hapura depozitimi deri në një vit	Njësia bazë	Tarifa (lekë)
a)	mallra rifuxho	lekë/m ² /ditë	2
b)	mallra gjenerale	lekë/m ² /ditë	4

6.5 Tarifat për qiratë për ambiente të tjera të Portit

1	Tarifa për qiratë e ambiente të tjera të Portit	Njësia bazë	Tarifa (lekë)
a)	ambiente për zyra	lekë/m ² /muaj	1,000
b)	shesh për zyrë mobile	lekë/m ² /ditë	7
c)	ambiente për operatorët kontraktualë ⁵	lekë/m ² /muaj	150
d)	sheshe për operatorët kontraktualë	lekë/m ² /muaj	100

6.6 Tarifat për qiradhënie të mjeteve

1.	Tarifa për qiradhënien e mjeteve	Njësia bazë	Tarifa (lekë)
a)	mjete transporti deri në 10 tonë	lekë/orë	2,550
b)	forklift deri 3 tonë	lekë/orë	2,501
c)	forklift deri 12 tonë	lekë/orë	3,843
d)	forklift deri 32 tonë	lekë/orë	10,736
e)	vinç mobil me rrota deri 16 tonë	lekë/orë	7,930
f)	vinç i rëndë i lëvizshëm me goma deri në 45 tonë	lekë/orë	10,736
g)	fadrome 2 m ³	lekë/orë	5,380
h)	reach stacker deri 45 tonë	lekë/orë	11,407

⁵ Operatorë kontraktualë janë operatorët që kanë një kontratë të vlefshme me APD-në, për kryerjen e shërbimeve apo të punëve. Ambientet dhe sheshet jepen me qira në funksion të realizimit të kontratës.

i)	MHC vinç portual mobil	lekë/orë	29,792
j)	elektrovinç 5 tonë	lekë/orë	6,032
k)	elektrovinç 10 tonë	lekë/orë	16,787
l)	elektrovinç 15, 16 dhe 27 tonë	lekë/orë	8,049
m)	elektrovinç 45 tonë	lekë/orë	31,947
2.	Tarifa për qiradhënien e mjeteve në terminalin e kontejnerëve	Njësia bazë	Tarifa lekë
a)	Vinç kalatë MHC 200	lekë/ditë	180,220
	Baza përlllogaritëse do të jetë 10 ditë dhe 100 orë pune dhe për çdo orë shtesë pas kësaj do të kryhet pagesa shtesë lekë për orë.	lekë/orë	18,022
b)	Vinç kalatë MHC 115	lekë/ditë	164,520
	Baza përlllogaritëse do të jetë 10 ditë dhe 100 orë pune dhe për çdo orë shtesë pas kësaj do të kryhet pagesa shtesë lekë për orë	lekë/orë	16,452
c)	Reachstacker	lekë/ditë	45,910
	Baza përlllogaritëse do të jetë 10 ditë dhe 100 orë punë dhe për çdo orë shtesë pas kësaj do të kryhet pagesa shtesë lekë për orë	lekë/orë	4,591
d)	ECH Empty container handler/mjet përpunimi kontejnerësh bosh	lekë/ditë	28,110
	Baza përlllogaritëse do të jetë 10 ditë dhe 100 orë pune dhe për çdo orë shtesë pas kësaj do të kryhet pagesa shtesë lekë për orë	lekë/orë	2,811
e)	Lifterak	lekë/ditë	10,800
	Baza përlllogaritëse do të jetë 10 ditë dhe 100 orë pune dhe për çdo orë shtesë pas kësaj do të kryhet pagesa shtesë lekë për orë	lekë/orë	1,080
f)	Kokat tërheqëse	lekë/ditë	7,290
	Baza përlllogaritëse do të jetë 10 ditë dhe 100 orë punë dhe për çdo orë shtesë pas kësaj do të kryhet pagesa shtesë lekë për orë	lekë/orë	729

6.7 Tarifat për reklamat

1	Tarifa për reklamat	Njësia bazë	Tarifa (lekë)
a)	reklamë statike e zakonshme	lekë/m ² vit	10,370



b)	reklamë e përbërë e lëvizshme me fletë	lekë/ m ² vit	12,200
c)	reklamë elektronike (digjitale, lineare)	lekë/ m ² vit	20,740

KAPITULLI 5 TARIFA TË TJERA

7. TARIFA TË TJERA

7.1 Tarifat për certifikatën e deratizimit

1	Certifikata e përjashtimit të deratizimit të anijes (afati 6 muaj)	Njësia bazë	Tarifa
a)	për anije 0-500 GT	€/certifikatë	50
b)	për anije 501-3000 GT	€/certifikatë	100
c)	për anije mbi 3000 GT	€/certifikatë	150

7.2 Tarifa për certifikatën mjekësore të anijes

1	Lëshimi i certifikatës mjekësore për anijen dhe personelin për një periudhë jo më pak se 12 muaj	Njësia bazë	Tarifa
a)	Certifikata mjekësore e anijes (vjetore)	€/anije	20
b)	Certifikata e personelit (vjetore)		
	i) për shqiptarë	€/person	5
	ii) për të huaj	€/person	10
c)	Certifikata e shërbimit gastronomik kuzhinier (njëvjeçare)	€/person	10
d)	Certifikata për personin e ndihmës së shpejtë (njëvjeçare)	€/person	10

7.3 Tarifa e shërbimit për mbrojtjen kundër zjarrit dhe shpëtimit

1.	Tarifa e shërbimit për mbrojtjen kundër zjarrit dhe shpëtimit	Njësia bazë	Tarifa
a)	Tarifë për orë në dispozicion	lekë/orë	2,000

7.4 Tarifat e parkingut

1. Parkimi i mjeteve brenda portit
2. Përkufizime
 - a) Parkingu i mjeteve në port është i lejuar vetëm në vendet e përcaktuara nga APD-ja
 - b) Parkimi jashtë zonave të lejuara përbën shkelje dhe largimi do të kryhet nën koston e pronarit të mjetit apo përdoruesit.

	Njësia bazë	Tarifa
3. Mjetet që parkohen në zonat operacionale		
a) mjetet deri 3,5 tonë	lekë/njësi/ditë	500
b) mjete 3,5 - 7,5 tonë	lekë/njësi/ditë	850
c) mjete mbi 7,5 tonë	lekë/njësi/ditë	1,000
4. Mjetet që parkojnë jashtë zonave operacionale		
a) mjetet deri 3,5 tonë	lekë/njësi/ditë	100
b) mjetet 3,5 -7,5 tonë	lekë/njësi/ditë	200
c) mjete mbi 7,5 tonë	lekë/njësi/ditë	300
5. Mjetet që parkojnë në vendparkimet e autorizuara		
a) Autovetura dhe automjete për transport të përzier	lekë/njësi/orë	50

Tarifat për parkimin e automjeteve aplikohet për mjetet që qëndrojnë në parkim mbi 4 orë.

7.5 Tarifat e personave dhe mjeteve që hyjnë në port.

Tarifat e hyrjes për:

	Njësia bazë	Tarifa (lekë)
1. Automjete deri dhe përfshirë 3.5 tonë	automjet/muaj	500
2. Automjete mbi 3.5 tonë deri në dhe përfshirë 7.5 tonë	automjet/hyrje	150
3. Automjete mbi 7.5 tonë	automjet/hyrje	250
4. Lejehyrje për person	person/vit	200
5. Lejehyrje automjeti e përkohshme	automjet	200

Autoriteti Portual Durrës mund të vendosë përjashtimin nga aplikimi i tarifës për pikën 7.5/1 automjete deri dhe përfshirë 3.5 tonë dhe pikën 7.5/4 lejehyrje për person, për kategori të caktuara individësh, institucionesh shtetërore apo organizatash jofitimprurëse.

7.6 Komisioni për mbledhjen e të ardhurave

- | | |
|---|--|
| 1. Komisioni për mbledhjen e të ardhurave | 1% e vlerës së të ardhurave të arkëtuara |
|---|--|

Për të ardhurat e mbledhura nga operatorët portualë dhe agjencitë e autorizuara nga Autoriteti Portual Durrës për llogari të APD do të aplikohet komisioni i mbledhjes së të ardhurave nga tarifat. Komisioni aplikohet në masën 1% të të ardhurave të arkëtuara.

7.7 Tarifë preferenciale për eksportin e sasive të mëdha të mineralit të hekurit

1. Për rastin e eksportit të mineralit të hekurit në sasi të mëdha jo më pak se 500.000 tonë në vit do të aplikohen tarifat preferenciale si më poshtë:



	Tarifat preferenciale	Njësia bazë	Tarifa
1.	Tarifa e kanalit dhe bazenit (sipas pikës 1.2.1)	euro/GT	0.207
2.	Tarifa e akostimit të kalatës (sipas pikës 2.2.1.e)	euro/metër/ditë	3.42
3.	Tarifa e ngarkimit (sipas pikës 3.3.2)	lekë/tonë	555.90
2.	Tarifat preferenciale të përcaktuara sipas kësaj pike do të aplikohen si më poshtë:		
a)	Pas përfundimit të eksportit të jo më pak se 500.000 tonë në vit;		
b)	Mbi të gjithë sasinë e eksportuar brenda periudhës njëvjeçare.		

Abonimet vjetore për Fletoren Zyrtare mund të bëhen pranë Postës Shqiptare ose pranë Qendrës së Botimeve Zyrtare, në adresën: Bulevardi “Gjergj Fishta”, mbrapa ish-eksponitës “Shqipëria Sot”, tel: 04 24 27 007.

Hyri në shtyp më 12.3.2013
Doli nga shtypi më 13.3.2013

	Formati: 61x86/8
--	------------------

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2013

Çmimi 50 lekë